

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5469
E hënë, 7 maj 2018
çmimi 0.40 €

Presidenti Thaçi të mërkurën takohet me Merkelin në Berlin

Kancelarja gjermane Angela Merkel këtë të mërkurë e pret për herë të parë në Berlin Hashim Thaçin, në cilësinë e presidentit të Kosovës. Në qendër të këtij takimi janë temat bilaterale dhe rajonale ■ FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", DUKAGJIN GORANI ■ FAQE 4-5

Nuk ka interesim që zgjedhjet të mbahen tani

- Me partinë e re, Socialdemokrate, do ta arsyetojmë plotësisht cilësimin ideologjik socialdemokrat

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Dukagjin Gorani, ka thënë se Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk e përkrah idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme gjatë këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka

thënë se arsye për këtë është se zgjedhjet nuk do të sjellin ndryshim përmbajtësor të qeverisjes, por vetëm ndërrim të Qeverisë me aktorë të ngjashëm në pushtet, mbase të njëjtë. Gorani ka folur edhe për formimin e partisë së re të

krahut socialdemokrat nga grupi parlamentar i 12 deputetëve të pavarur, pjesë e së cilës është edhe ai. "Partia e re, Socialdemokrate, do të përipiqet t'i shpërfaqë dhe t'i plasojë aftësitë profesionale të anëtarëve të saj, në të mirë të zhvillimit të vendit", ka thënë Gorani

Pas 14 qershorit, EULEX-i i panevojshëm në Kosovë

Përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës e shohin të panevojshme praninë e EULEX-it në Kosovë pas 14 qershorit. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sistemi i drejtësisë ka kapacitete

për ta bërë punën në përputhje të ligjeve, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it. Edhe deputeti opozitar, Naser Rugova, ka thënë për gazetën se EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin. Ndërkaq njohësi i

çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja dhe profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, e kanë vlerësuar të domosdoshme edhe më tutje praninë e EULEX-it, por në një format tjetër ■ FAQE 5



Kurti: Zajednicën duan ta sjellin gjatë pushimit të Kuvendit

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të kësaj partie, ka thënë të dielën se kjo Qeveri po dëshiron që

Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe (Zajednicën) ta formojë në kohën kur Kuvendi i Kosovës është në pushim, gjatë muajit gusht ■ FAQE 5

AKTUALE

ZVOGËLIMI I
PAGAVE TË
PUNËTORËVE TË
PTK-së NUK
ËSHTË SHPËTIMI
I SAJ. 11



JAKUP KRASNIQI

RAMA KONFIRMON
RIKANDIDIMIN E VELIAJT
PËR KRYETAR TË TIRANËS. 2

LUAN HARADINAJ ISHTE
LUAN I UÇK-së. 6

EKONOMI

NORMAT E INTERESIT PËR
DEPOZITA, ULJE DRASTIKE. 9

NË KËTA SEKTORË SHPREHIN
INTERESIM NDËRKOMBËTARËT. 8

KULTURË

GOGOLI. 16

DINO BUZZATI

FUQIA POLITIKE E
PËRKTHIMIT. 16

CHENXING JIANG

SPORT

DRITA DHE PRISHTINA,
FYT PËR FYT. 18

NUHU SHËNON TRE GOLA
NDAJ NORWICHIT. 18

RENOVA
PUTZ
Magdori
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Serbia ta njohë Kosovën dhe të mos e pengojë themelimin e ushtrisë

Në raportin e Komiteti Kombëtar Amerikan për Politika të Jashtme për Ballkanin ceket nxitja e BE-së për ta kthyer në agjendë dialogun Kosovë - Serbi, edhe krijimin e Ushtrisë së Kosovës, e pajisur me armatim të lehtë, pa iu lejuar vetoja Serbisë në këtë çështje

WASHINGTON, 6 MAJ - Komiteti Kombëtar Amerikan për Politika të Jashtme thotë se Serbisë duhet t'i bëhet e qartë se nuk mund të anëtarësohet në Bashkimin Evropian pa e njohur Kosovën dhe se nuk mund ta pengojë Kosovën të bëhet anëtare, nëse Serbia anëtarësohet fillimisht. Në këshillat që jepen për diplomacinë amerikane në raport me Ballkanin Perëndimor theksi vihet edhe te nxitja e Bashkimit Evropian për ta kthyer në agjendë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, edhe krijimin e Ushtrisë së Kosovës, e pajisur me armatim të lehtë, pa iu lejuar vetoja Serbisë në këtë çështje. I titulluar "Koha për veprim në Ballkanin Perëndimor - përshkrim politikash për diplo-

macinë amerikane", ky raport 24 faqesh, ndër autorët e të cilit është Frank Wisner, dikur ndërmjetës i diplomacisë amerikane në bisedimet për statusin final të Kosovës - përmend ngecjen e implementimit të marrëveshjeve të arritura mes dy vendeve si tregues i rrezikshëm i kthimit në një konflikt të ngrirë të mosmarrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë. Bashkautorët e tjerë janë personalitete eminentë: Thomas E. Graham, Jonathan E. Levitsky, Ambasadori Cameron P. Munter, ndërsa kontribut kanë dhënë edhe Mark D. Stadnyk dhe Stephen C. Whittaker. Këshillohet që palët të kthehen në tryezën e diskutimeve, pasi ta kenë nisur zbatimin e



marrëveshjeve dhe të ecin drejt normalizimit të raporteve, që në shkallë të fundit do të thotë njohje e Kosovës nga Serbia. Veç këtyre dimensioneve, këshillohet funksionalizimi i

Gjykatës Speciale dhe mospengimi i saj, ndërsa BE-ja dhe ShBA-ja të punojnë për riafirmimin e rugës evropiane të Kosovës, megjithëse mbetet shumë për t'u bërë në këtë rrugëtim. Para se të hyjë në

BE, Serbisë duhet t'i kërkohet njohja e Kosovës. Nëse Serbia anëtarësohet përpara shtetit tonë, nuk duhet t'i lejohet pengimi i anëtarësimit të Kosovës në BE.

Rama konfirmon rikandidimin e Veliajt për kryetar të Tiranës

TIRANË, 6 MAJ - Teksa puna vijon në disa segmente në kryeqytet, edhe Erion Veliaj synon të vijojë të jetë në krye të Bashkisë më të madhe në vend. Në inaugurimin e segmentit të dytë të Bulevardit të Ri, Veliaj ka marrë edhe mbështetjen e Edi Ramës edhe për një mandat të dytë si kryebashkiak i Tiranës.



Kryeministri Rama theksoi se bashkë me kryebashkiakun Veliaj në mandatin tjetër qeverisës do të bëhet shumë më tepër sesa është bërë në këta tre vjet duke siguruar për realizimin e një sërë investimesh të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët e

Tiranës. "Së bashku me projektet e Qeverisë për Tiranën, së bashku me një sërë projektesh që shpresojmë të financohen me partnerët, na jep mundësi të themi jo vetëm në këtë mandat

të kryetarit të bashkisë së Tiranës ne do të bëjmë shumë më tepër se çfarë është bërë në shumë vite së bashku, por në mandatin e ri qeverisës ne do të bëjmë me siguri me kryetarin e bashkisë dhe me bashkinë e Tiranës shumë më tepër sesa është bërë në këta tre vjet të bashkisë së Tiranës", theksoi Rama. Duke vlerësuar transformimin që ka pësuar e gjithë kjo zonë ku po ndërtohet bulevardi i ri dhe rehabilitimin e lumit të Tiranës, kryeministri vlerësoi përkushtimin e Bashkisë së Tiranës dhe të kryebashkiakut Veliaj. "Sikur ky bulevard të ndërtohej me rit-

met që përcaktuan ecurinë e tij në katër vjetet para zgjedhjes së Erionit në krye të bashkisë do të duheshin 60 vjet për të arritur këtu ku jemi sot dhe mbase dhe 30 vjet të tjera për të shkuar aty ku faktikisht do të shkojmë deri në fund të vitit të ardhshëm. E gjitha kjo sepse kemi organizuar një punë të përbashkët. Jemi koordinuar më së miri dhe është bërë e mundur sinergia e të gjithë aktorëve dhe faktorëve, ku pa dyshim mbetet e çmuar prania e Fondit të Abu Dabit", nënvizoi Rama.

Teksa komentoi projektin, Rama tha se Tirana tashmë do të ketë edhe një sipërfaqe të gjelbër të

krahasueshme për nga përmasat me Parkun e Liqenit. "Jo vetëm se kemi një aks të ri ekologjik në vijën e lumit të Tiranës, jo vetëm me kryerjen e këtyre punimeve krijohet një mundësi e re qarkullimi për banorët, por së shpejti do të marrë jetë edhe një park i ri qendror dhe gjithë volumi i hapësirës së gjelbëruar dhe i atraksioneve të një parku, një volum plotësisht i krahasueshëm me atë që sot është Parku ekzistues i Liqenit të Tiranës dhe kjo është një vepër që është e dyta në historinë e qytetit në përmasën e gjelbër pas parkut të liqenit të Tiranës", shtoi Rama.

Presidenti Meta nderon kujtimin dhe sakrificat e dëshmorëve të atdheut

TIRANË, 6 MAJ - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, zhvilloi homazhe të dielën paradite në "Varrezat e Dëshmorëve", ku vendosi një kurorë me lule, duke u përlurur me respekt para Monumentit të "Nënës Shqipëri". Presidenti i Republikës u shpreh para medieve të pranishme se ishte kënaqësi të takohet edhe

me përfaqësuesit e familjeve të dëshmorëve. "Natyrshat ata janë kaq të shumtë, por të gjithë bashkë i bashkon përjetësia në nderim të asaj që kanë bërë për çlirimin e vendit, për 29 Nëntorin, që e vendosi Shqipërinë në anën e drejtë të historisë. Dhe jo vetëm riktheu 28 Nëntorin, që humbën më 7 prill, por njëkohësisht edhe ka

bërë të mundur që Shqipëria sot të jetë edhe anëtare e NATO-s por, pse jo, edhe të ketë një perspektivë shumë të mirë edhe për çeljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, pasi ishin ata që përcaktuan rrugën evropiane të Shqipërisë, ashtu sikurse edhe heroit ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu", tha Meta.



Pas 14 qershorit, EULEX-i i panevojshëm në Kosovë

Përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës e shohin të panevojshme praninë e EULEX-it në Kosovë pas 14 qershorit. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sistemi i drejtësisë ka kapacitete për ta bërë punën në përputhje të ligjeve, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it. Edhe deputeti opozitar, Naser Rugova, ka thënë për gazetën se EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin. Ndërkaq njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja dhe profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, e kanë vlerësuar të domosdoshme edhe më tutje praninë e EULEX-it, por në një format tjetër

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 6 MAJ - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se gjatë këtyre muajve ka pasur një angazhim të madh për sundim të ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit e krimin të organizuar. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re", se sistemi i drejtësisë tashmë ka kapacitete për ta bërë punën në përputhje të ligjeve, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it. "Sipas marrëveshjes ekzistuese, mandati i EULEX-it përfundon në qershor dhe ne si institucione jemi duke punuar për të marrë përsipër çdo aspekt që asnjë lloj zbrazëtie të mos mbetet me rastin e përfundimit

të këtij misioni. Në aspektin real, pa marrë parasysh performancën e EULEX-it në kuptimin e përgjithshëm, i njëjti ka kontribuar për fuqizimin e institucioneve vendore, veçmas organeve të pavarura të zbatimit të ligjit, prandaj në rrafshin praktik konsideroj se në kuptimin e ngushtë tashmë Republika e Kosovës nuk ka detyrimisht nevojë për këtë mision. Megjithatë, se a është e nevojshme një fazë tranzicioni gjatë këtij mandati para se të thuhet se i njëjti do të mbyllet përfundimisht dhe, nëse po, cili do të jetë roli i tij, kjo është një çështje përcaktimi për të cilën i takon një niveli ndërinstitucional të vendimmarjes. Si ministër i Drejtësisë jam i bindur se sistemi i drejtësisë,

përkatësisht gjyqësori dhe prokuroria, tashmë kanë kapacitetet profesionale dhe buxhetore për ta bërë punën e tyre konform ligjeve në fuqi, pa pasur nevojë për një mision ekzekutiv të EULEX-it", ka deklaruar Tahiri.

Edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Naser Rugova, ka thënë të dielën për gazetën "Epoka e re", se EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin në përputhje me marrëveshjen aktuale dhe Kosova si shtet i ri duhet të ecë përpara. Sipas tij, pas 14 qershorit, pavarësisht prej dobësiveve shteti i Kosovës ka potencial dhe kapacitete për të ndërtuar një gjyqësor të pavarur e të përgjegjshëm. "Në këtë kuptim duhet falënderuar Bashkimin Evropian dhe misionin e EULEX-it për ndihmën modeste, sepse edhe si qytetar edhe si i zgjedhur i popullit kam vërejtje serioze në mandatin e këtij misioni. Prandaj, përfundimi i mandatit të EULEX-it duhet të jetë një motiv shtesë për shtetin e Kosovës, në veçanti për Kuvendin që të bëjë reformë substanciale të gjyqësorit përmes ligjeve adekuate. EULEX-i duhet ta përfundojë mandatin në përputhje me marrëveshjen dhe Kosova si shtet i ri duhet të ecë vetë përpara. Pas 14 qershorit Kosova

duhet t'i marrë të gjitha përgjegjësitë e nevojshme edhe në fushat e ndjeshme siç janë disa dikastere të gjyqësorit", ka deklaruar Rugova, duke shtuar se pas 14 qershorit prania e misionit EULEX në Kosovë nuk është e nevojshme. "10 vjet ndihmë, monitorim dhe mbështetje në aspekte të caktuara mendoj se janë mjaft. Kosova ka kapacitete intelektuale dhe profesionale, por duhet të ketë konsensus dhe vullnet politik që vërtet gjyqësorin ta lëmë në duar të njerëzve të pavarur dhe profesionistë, në mënyrë që të ecë përpara kjo shtyllë kryesore e shtetit. Konsideroj se prania e misionit të EULEX-it pas 14 qershorit nuk është e nevojshme në Kosovë. Duhet t'ia lë duart e lira gjyqësorit të Kosovës që të zhvillohet dhe të forcohet duke e kryer punën e vet në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën", është shprehur Rugova.

Për dallim prej përfaqësuesve të pushtetit dhe të opozitës, njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se duke pasur për bazë brishtësinë me të cilën po ballafaqohet sistemi juridik i Kosovës, edhe më tutje ka nevojë për kuadrin juridik evropian, por në një formë tjetër. "EULEX-i ka kryer disa detyra, por jo aq sa kemi pritur për sundim të ligjit në Kosovë. Janë evidentuar disa dobësi të këtij misioni. Është

përfolur edhe çështja e korrupsionit dhe nepotizmit në mesin e këtij misioni. Pavarësisht prej kësaj, mendoj se ekspertët juridikë dhe politikanët tanë duhet ta diskutojnë çështjen e pranisë së mëtejme të EULEX-it. Sidoqoftë, një prani, por jo në këtë formë të kuadrin juridik evropian, duhet të ekzistojë edhe më tej në Kosovë, duke pasur për bazë brishtësinë me të cilën po ballafaqohet sistemi ynë juridik. Për formën organizative dhe të tjera duhet të vendoset pas konsultave me ekspertët", ka deklaruar Qehaja.

Kurse profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka thënë të dielën për gazetën "Epoka e re" se edhe pas 14 qershorit prania e EULEX-it në Kosovë është e domosdoshme. "Duke pasur parasysh gjendjen që e kemi në sistemin e drejtësisë, po ashtu duke pasur parasysh se ende nuk është krijuar në një atmosferë të volitshme që të ndërtohet sintagma 'askush mbi ligjin', si dhe duke pasur parasysh se ekzistojnë një grup njerëzish të fortë me pushtet dhe para, mendoj se është e domosdoshme edhe për një kohë, qoftë drejtpërdrejt me lëndë apo si këshilltarë e mbështetës", është shprehur Salihu. Sipas marrëveshjes ekzistuese, mandati aktual i EULEX-it përfundon më 14 qershor të këtij viti.



Flet për "Epokën e re", Dukagjin Gorani

Nuk ka interesim që zgjedhjet të

- Me partinë e re, Socialdemokrate, do ta arsyetojmë plotësisht cilësimin ideologjik socialdemokrat

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Dukagjin Gorani, ka thënë se Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk e përkrah idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme gjatë këtij viti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se arsye për këtë është se zgjedhjet nuk do të sjellin ndryshim përmbajtësor të qeverisjes, por vetëm ndërrim të Qeverisë me aktorë të ngjashëm në pushtet, mbase të njëjtë. Gorani ka folur edhe për formimin e partisë së re të krahut socialdemokrat nga grupi parlamentar i 12 deputetëve të pavarur, pjesë e së cilës është edhe ai. "Partia e re, Socialdemokrate, do të përpiket t'i shpërfaqë dhe t'i plasojë aftësitë profesionale të anëtarëve të saj, në të mirë të zhvillimit të vendit", ka thënë Gorani

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 MAJ - Deputeti Dukagjin Gorani ka bërë me dije se subjekti i ri politik i Grupit të Deputetëve të Pavarur (GDP) do të përpiket ta arsyetojë plotësisht cilësimin ideologjik socialdemokrat. Ai ka sqaruar se kjo nënkupton interpretimin e qytetarit dhe të shoqërisë kryesisht nga përkatësia socio-ekonomike, e jo vetëm nga këndi identitar, historik dhe etno-kulturor. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gorani ka deklaruar se në këtë mënyrë po formojnë një parti të së ardhmes, e cila do të jetë e gatshme të ballafaqohet me sfidat e reja. "Para së gjithash, do të jetë përqendrimi në qytetarin si kategori sociale dhe ekonomike. Subjekti i ri do të përpiket që mbase për herë të parë ta arsyetojë plotësisht cilësimin ideologjik socialdemokrat e që, mes të tjerash, nënkupton edhe interpretimin e qytetarit dhe të shoqërisë kryesisht nga përkatësia socio-ekonomike, e jo vetëm nga këndi identitar, historik dhe etno-kulturor", ka thënë Gorani.

Ai ka vlerësuar se dekadat e mobilizimit popullor karshi kërcënimeve etnike e territoriale janë para përfundimit. "Kosova, shqiptarët dhe të gjitha komunitetet e saj duhet të përgatiten për një shoqëri të zhvilluar ekonomikisht, të pangarkuar kulturalisht dhe të integruar

strukturalisht. Është ky nivel i ri në historinë e zhvillimit tonë që do të fillojë relativisht shpejt: me liberalizim të vizave dhe ulëse në OKB. Sfidat para nesh do të jenë të rënda, por edhe të ndryshme: prej Republikës së Kosovës do të pritet më shumë ekspertizë zhvillimore, më shumë përqendrim në drejtësi, integrim të shoqërisë, arsim e shëndetësi, e shumë më pak në histori politike apo në interpretime të trashëgimisë së konflikteve rajonale", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Gorani ka folur edhe për situatën aktuale politike në vend. Sipas tij, asnjë subjekt politik nuk është i interesuar që zgjedhjet e reja të mbahen tani. "Pavarësisht prej tensioneve që u ngrehën gjatë ditëve të kaluara, mungesa e vullnetit për zgjedhje të shpejta e të parakohshme u kuptua në tryezën e fundit të partive politike, të organizuar nga LDK-ja. Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk e përkrah idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme gjatë këtij viti. Arsyeja për këtë është se ato nuk do të sjellin ndryshim përmbajtësor të qeverisjes, por vetëm ndërrim të Qeverisë me aktorë të ngjashëm në pushtet, mbase të njëjtë", ka thënë Gorani.

"Epoka e re": Z. Gorani, para disa ditësh keni prezantuar deklaratën e parimeve mbi bazën e së cilës do ta vazhdojë rrugëtimin politik Grupi i Deputetëve të Pavarur (GDP).



Cilat janë synimet e këtij subjekti politik?

Gorani: Para së gjithash, do të jetë përqendrimi në qytetarin si kategori sociale dhe ekonomike. Subjekti i ri do të përpiket që mbase për herë të parë ta arsyetojë plotësisht cilësimin ideologjik socialdemokrat e që, mes të tjerash, nënkupton edhe interpretimin e qytetarit dhe të shoqërisë kryesisht nga përkatësia socio-ekonomike, e jo vetëm nga këndi identitar, historik dhe etno-kulturor. Dekadat e mobilizimit popullor karshi kërcënimeve etnike e territoriale janë para përfundimit. Kosova, shqiptarët dhe të gjitha komunitetet e saj duhet të përgatiten për një shoqëri të zhvilluar ekonomikisht, të pangarkuar kulturalisht dhe të integruar strukturalisht. Është ky nivel i ri në historinë e zhvillimit tonë që do të fillojë relativisht shpejt: me liberalizim të vizave

dhe ulëse në OKB. Sfidat para nesh do të jenë të rënda, por edhe të ndryshme: prej Republikës së Kosovës do të pritet më shumë ekspertizë zhvillimore, më shumë përqendrim në drejtësi, integrim të shoqërisë, arsim e shëndetësi, e shumë më pak në histori politike apo në interpretime të trashëgimisë së konflikteve rajonale.

"Epoka e re": Çfarë do ta dallojë këtë parti prej subjekteve të tjera ekzistuese?

Gorani: Pikërisht kjo që thashë. Përqendrimi në ekspertizë zhvillimore të përfaqësuesve, ekspertëve dhe të anëtarësisë së saj, me gjithë botëvështrimin progresiv karshi realitetit divers etnik dhe kulturor të shoqërisë. Mbase ky formulim nuk tingëllon gjë e re, porse zbatimimi real dhe praktik i tij gjithsesi do të nënkuptonte risi të madhe për vendin.

"Epoka e re": Cila do të jetë strategjia publike e angazhimit tuaj politik dhe kush do ta udhëheqë këtë parti?

Gorani: Partia e re, Socialdemokrate, do të përpiket t'i shpërfaqë dhe t'i plasojë aftësitë profesionale të anëtarëve të saj, në të mirë të zhvillimit të vendit. Në Deklaratën e Parimeve themeluese që e publikuam ditë më herët i shpjeguam vlerat e përbashkëta, zbatimin e të cilave e synojmë për shoqërinë tonë. Më 9 maj, të mërkurën, do të mbahet edhe Konventa Zgjedhore e subjektit. Aty do të qartësohen çështjet strukturore dhe organizative. Aty do të votohen kandidatët e propozuar.

"Epoka e re": Ajo që di opinionin për strukturën e këtij subjekti politik janë 12 deputetë që keni në Kuvend. Deri më tani keni identifikuar individë të caktuar për ta shtrirë këtë parti nëpër

mbahen tani



Lëvizja Vetëvendosje mban Këshillin e Përgjithshëm

Kurti: Zajednicën duan ta sjellin gjatë pushimit të Kuvendit

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të kësaj partie, ka thënë të dielën se kjo Qeveri po dëshiron që Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe (Zajednicën) ta formojë në kohën kur Kuvendi i Kosovës është në pushim, gjatë muajit gusht

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 6 MAJ - Lëvizja Vetëvendosje të dielën ka mbajtur mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm ku është folur për zhvillimet e përgjithshme në vend dhe brenda kësaj lëvizjeje. Lideri i kësaj lëvizjeje, Albin Kurti, në fillim të fjalës së tij ka thënë se gjatë tre muajve të shkuar, që prej mbledhjes së kaluar të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, ka ndodhur shumëçka në politikë. "Megjithatë, nga këndvështrimi i një qytetari, pra nëse e pyet një qytetar të Kosovës sot se çfarë ka ndodhur gjatë këtyre tre muajve, ai do të thotë asgjë. Nga perspektiva e qytetarit nuk ka ndodhur 'asgjë', edhe pse është organizuar me spektakël të madh arrestimi i Gjuriqit, edhe pse me një kontratë shumë të dyshimtë e jotransparente po e shesin të drejtën e shfrytëzimit të thëngjillit në Kosovë, edhe pse po e falimentojnë Postën me qëllim për ta privatizuar, edhe pse u zbulua se populli po ushqehet me mish e ushqime të prishura prej tregtarëve e

importuesve të mëdhenj. Po ashtu, i kanë falur 8 200 hektarë, me premtimin e rrejshëm se do të na liberalizoheshin sakaq vizat", ka thënë Kurti.

Ai ka pohuar se ky koalicion qeverisës dëshiron ta sjellë "Zajednicën" në muajin gusht kur, sipas tij, Kuvendi është në pushim e kur qytetarët janë të shpërqendruar nga politika, pasi ata presin në atë kohë të afërmit e tyre që vijnë nga jashtë vendit, apo të tjerët që janë duke organizuar dasma apo kanë shkuar në plazh. "Politikë e ulët e qeverive frikacake. Kjo është Qeveria e tashme sikurse ato të mëparshmet, që sjellin vendime të cilat shkatërrojnë sovranitetin e Kosovës, në një kohë kur praktikisht e gjithë politika është e suspenduar. Vlen të kujtojmë këtu se njësoj, në gusht të vitit 2015, Thaçi e Mustafa i nënshkruan marrëveshjet katasastrofale, për të mos u përballur me Kuvendin e me popullin", ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se "Zajednica" nuk është organizatë joqeveritare. "Është e Qeverisë së Serbisë, me miratimin dhe bekimin e Qeverisë së Kosovës", është shprehur Kurti.

Lideri i LV-së ka bërë me dije se dialogun Kosovë - Serbi nuk duhet ta udhëheqë presidenti aktual Hashim Thaçi. Kurti ka shtuar se kjo Qeveri aktuale, e cila nuk i ka numrat, po mbahet në pushtet vetëm për ta kryer punën e keqe me "Zajednicën" siç e kreu me demarkacionin me Malin e Zi. Ai ka folur edhe për Lëvizjen Vetëvendosje të cilën e drejton. Kurti ka thënë se ishin një hap para fitores, kur e morën një goditje të rëndë e të mirorganizuar, nga brenda e nga jashtë. "Aktivistët dhe qytetarët këtë herë u treguan më të mençur e më të organizuar sesa ata që dëshiruan ta shkatërrojnë Lëvizjen Vetëvendosje. Dhe, ja ku jemi, sërish vetëm një hap larg fitores. Me pak më shumë punë nga ne e nga ju, me seriozitet e përkushtim, Lëvizja mund të vijë shumë shpejt në pushtet", ka thënë Kurti, duke shtuar se mbështetja për Lëvizjen Vetëvendosje është popullore, ajo ekziston dhe është masive. "Është detyra jonë ta strukturujmë atë, ta forcujmë e ta rrisim atë duke punuar dhe duke u angazhuar në organizatën tonë dhe jashtë saj", ka deklaruar Kurti.

tërë Kosovën?

Gorani: Veç 12 deputetëve në Kuvend, janë edhe një numër i konsiderueshëm i aktivistëve dhe bashkëpunëtorëve të angazhuar rreth subjektit të ri, nga pothuajse të gjitha qendrat kryesore të Kosovës. Mirëpo, para së gjithash, duhet të konstituohet bërthama funksionale e subjektit që pritet të bëhet të mërkurën. Vetëm pas kësaj do të mund të angazhohemi formalisht në strukturimin e tij, përmbajtjesor e hapësinor.

"Epoka e re": Qeveria aktuale nuk e ka shumicën në Kuvend, kurse opozita ka paralajmëruar zgjedhje të reja. Sa do të jeni të gatshëm për zgjedhje dhe cilat janë pritjet tuaja nëse zgjedhjet e parakohshme mbahen së shpejti?

Gorani: Është situatë paradoksale kjo në Kuvend, ku opozita e kontrollon shumicën. Po ashtu, mbetet i paqartë roli i Listës

Serbe në koalicionin qeveritar: ata sillen si opozitë, porse mbajnë funksione qeveritare. Diçka e tillë është përbuzje e sistemit shtetëror, por edhe arrogancë publike e këtyre përfaqësuesve të komunitetit serb. Sa për zgjedhje, me gjasë askush nuk është i interesuar që ato të mbahen tani. Më shumë ka interesim për datë të mbajtjes së tyre. Pavarësisht prej tensioneve që u ngritën gjatë ditëve të kaluara, mungesa e vullnetit për zgjedhje të shpejta e të parakohshme u kuptua në tryezën e fundit të partive politike, të organizuar nga LDK-ja. Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk e përkrah idenë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme gjatë këtij viti. Arsye për këtë është se ato nuk do të sjellin ndryshim përmbajtjesor të qeverisjes, por vetëm ndërrim të Qeverisë me aktorë të ngjashëm në pushtet, mbase të njëjtë.



Luan Haradinaj ishte luan i UÇK-së

Liderët e institucioneve të Kosovës kanë përkujtuar të dielën heroin e kombit, Luan Haradinaj, duke bërë homazhe te varri i tij në Glllogjan. Në 21-vjetorin e rënies së tij, Luan Haradinaj është vlerësuar luan i UÇK-së dhe brezi i parë i luftës çlirimtare të Kosovës

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Në përkujtim të 21-vjetorit të rënies së dëshmorit të kombit, gjeneral-major Luan Haradinaj, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, së bashku me kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, të dielën kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Glllogjan. Pas homazheve, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se janë mbledhur për ta përkujtuar një atdhetar të shquar të përmasave kombëtare, Ismail Haradinaj, ideolog i çështjes kombëtare, prijës i lëvizjeve të hershme për lirinë e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, njëkohësisht për luftëtarin e hershëm Luan Haradinaj, i cili, po ashtu, ishte nga brezi i parë i luftëtarëve dhe veprues në veprimet e para për liri, mbështetës për mbarëvajtje dhe funksionim të UÇK-së e deri në komandim. "Këtë nder sot e kanë bërë të madh të gjithë pjesëmarrësit me praninë e tyre", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke falënderuar të gjithë ata që bënë nderim në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Glllogjan, kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, familjet e dëshmorëve, bashkëluftëtarët e gjallë dhe gjithë të tjerët.

Kurse kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se ka pasur fatin të bashkëveprojë me një luftëtar siç ishte Luan Haradinaj. Po ashtu, homazhe janë bërë edhe pranë shtatores së dëshmorit të kombit Luan Haradinaj, në Deçan dhe heroit të kombit Sali Çekaj.

Luan Haradinajn e ka përkujtuar edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili ka vlerësuar se Luani i takonte brezit të parë të luftës çlirimtare të Kosovës. "21 vjet më parë, në një nga betejat e para të UÇK-së, ra heroikisht dëshmorin i kombit Luan Haradinaj. Luani i takonte brezit të parë të luftës çlirimtare të Kosovës. Veprat e Luanit dhe të luftëtarëve të tjerë të UÇK-së janë gurthemeli i Kosovës së lirë. Republika e Kosovës do t'i nderojë përjetë të gjithë ata që luftuan për lirinë e Kosovës. I përjetshëm qoftë kujtimi për Luanin dhe të gjithë dëshmorët e tjerë!", ka shkruar Limaj në profilin e tij në "Facebook".

Ndërsa nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, ka shkruar se Luan Haradinaj ishte vërtet luan i UÇK-së. "Sot bëhen 21 vjet nga rënia e njerit nga pjesëtarët e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Luan Haradinaj. Ai ra në krye të detyrës për ta ndihmuar



grupin për të hyrë në Kosovë. Por, fitoi pavdekësinë. Luanin e kisha më shumë se vëlla. Ai ishte vërtet luan i UÇK-së. Ishte ndër të rrallët i përgatitur për të vepruar në Kosovë dhe në Shqipëri. Për të gjitha detyrat e ngarkuara, Luani asnjëherë nuk tha: Nuk mundem.. Ishte i përpiktë dhe jo rrahajoks. Luani meriton të nderohet dhe të respektohet përjetësisht nga kombi shqiptar", ka shkruar Haliti në profilin e vet në "Facebook".

Me rastin e 21-vjetorit të rënies së heroit Luan Haradinaj nga shoqatat e luftës së UÇK-së është organizuar edhe akademi përkujtimore, në të cilën ka marrë pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi.

Sot në Besianë bëhen homazhe në nderim të heroit Bahri Fazliu

BESIANË, 6 MAJ - Sot (e hënë) shënohet 20-vjetori i rënies heroike të Bahri Fazliut. Nga ora 12:00 në fshatin Llaushë të Besianës, tek lapidari i heronjve Fahri dhe Bahri Fazliu, do të bëhen homazhe për heroin e Kosovës Bahri Fazliu.



LDK-ja përkujton akademik Fehmi Aganin



Prishtinë, 6 maj (ER) - Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), së bashku me familjarët e profesorit të ndjerë Fehmi Agani, kanë bërë të dielën homazhe dhe nderime në 19-vjetorin e vrasjes së tij. "Ne sot, si kryesi e LDK-së, së bashku me familjarët, jemi këtu në nderim të jetës dhe veprës së profesorit dhe akademikut, njeriut të shkencës dhe politikës e të institucioneve, profesor Fehmi Aganit. Në përkujtim të punës së tij të madhe, në 19-vjetorin e vrasjes së tij nga bandat

policore, ushtarake dhe paramilitare serbe, çdo vit pa dyshim se po ndihet mungesa e profesor Aganit. Mençuria e tij, intelektualiteti, largpamësia dhe vizioni i tij si kurrë më parë i duhen edhe sot Kosovës", u shpreh sekretari i përgjithshëm i LDK-së, Ismet Beqiri. Ndërsa Mentor Agani, djali i profesor Aganit, ka falënderuar kryesinë e LDK-së për homazhet dhe respektin që po tregon për profesor Aganin. "Na mungon të gjithëve", ka thënë Mentor Agani.

Dhjetë vrasje për katër muaj, disa nga plumbat qorr

PRISHTINË, 6 MAJ - Gjatë katër muajve të parë të këtij vit në Kosovë kanë ndodhur dhjetë vrasje, disa prej të cilave nga plumbat qorr. Një gjë të tillë e kanë konfirmuar zyrtarët e Policisë së Kosovës.

Zëdhënësi i policisë, Bajram Krasniqi, ka thënë për "Radio

Kosovën" se të gjitha vrasjet në polici regjistrohen njëjtë, pavarësisht nëse janë nga plumba qorr apo çfarë lloji tjetër i vrasjes. Krasniqi ka thënë se Policia e Kosovës vazhdimisht ka bërë thirrje dhe ka organizuar kampanja të ndryshme për sensibilizim

të qytetarëve për mospërdorim të armëve nëpër festa. "Policia e Kosovës gjatë sezonit të verës harton një plan operativ që të kenë kujdes te restorantet ku organizohen ahengje dhe dasma, në mënyrë që të ketë sa më pak festime me armë. Gjatë

vitit të kaluar policia i ka konfiskuar 1 200 armë të llojeve të ndryshme dhe rreth 26 mijë copë municion të kalibrave të ndryshme", ka thënë Krasniqi.

Gjatë vitit të kaluar në Kosovë janë vrarë 27 persona, prej të cilëve disa nga plumbat qorr.



Presidenti Thaçi të mërkurën takohet me Merkelin në Berlin

Kancelarja gjermane Angela Merkel këtë të mërkurë e pret për herë të parë në Berlin Hashim Thaçin, në cilësinë e presidentit të Kosovës. Në qendër të këtij takimi janë temat bilaterale dhe rajonale

PRISHTINË, 6 MAJ - Më 9 maj (e mërkurë) kancelarja gjermane Angela Merkel do ta presë në Berlin presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Lajmin e ka konfirmuar, në javën që lamë pas, edhe zëdhënësja e Qeverisë së Gjermanisë, Martina Fietz, e cila ka bërë me dije se në qendër të bisedimeve do të jenë çështjet bilaterale dhe rajonale. Një prej temave kryesore pritet të jetë ajo e dialogut në mes të Serbisë dhe Kosovës. Angela Merkel ka pasur rastin të informohet mbi këtë dialog nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Ndërsa Kosova i ka zhvilluar bisedimet me Gjermaninë deri tani në nivele më të ulëta, por jo më pak intensive.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, rregullisht shkon në Berlin për ta marrë mendimin e partnerëve gjermanë. Konkretisht javën e kaluar ai pati zhvilluar takime me stafin e kancelares Merkel dhe në Drejtorinë e Ballkanit Perëndimor në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Temë kryesore ka qenë dialogu me Serbinë, ku Enver Hoxhaj ka bërë të qartë pritjet e Qeverisë së Kosovës për një plan kohor dhe për caqet e këtij dialogu, i cili ndodhet në prag të përmbylljes. "Nuk mund ta vazhdojmë dialogun me një qasje të dykuptimësisë. Neve na hynë në punë një marrëveshje që njëherë e përgjithmonë e mbyll një temë të hapur bilat-

erale që është njohja mes dy shteteve", i tha Hoxhaj "Deutsche Welle"-s në shqip. Po ashtu, një cak tjetër që dëshiron Kosova në përmbyllje të bisedimeve është anëtarësimi në OKB dhe mbështetje për liberalizimin e vizave.

Gjermania, si ideatorja e bisedimeve tekniko-juridike në mes të Kosovës dhe Serbisë, është një nga vendet kryesore që mbështet dialogun që po zhvillohet aktualisht mes dy vendeve në Bruksel. Por, shteti me ekonominë më të fuqishme në BE është i rëndësishëm edhe për temën tjetër në agjendën në mes të BE-së dhe Kosovës, liberalizimin e vizave.

Kosova shpreson të marrë një rekomandim pozitiv në këtë drejtim, pas miratimit përfundimtar të Ligjit të demarkacionit me Malin e Zi. "Qëndrimi i Komisionit Evropian deri tani ka qenë favorizues për Kosovën, meqë edhe për znj. Mogherini përmbyllja e kriterit të demarkacionit ishte përmbyllja më e rëndësishme. Ne kemi bërë edhe një përpjekje serioze për ta adresuar temën e luftës kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit, por na duhet edhe mbështetja e shteteve anëtare. GJERMANIA është një nga shtetet kryesore", ka thënë Hoxhaj.

Në kuadër të krijimit të një opinionimi për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për afrimin e tyre me BE-në, Angela Merkel u ka pritur thujasë të gjithë kërret



e shteteve të rajonit në Berlin. Pas takimit me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ajo do të darkojë me anëtarët e presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Izetbegović, Ivaniç dhe Çoviç. Këto ditë ajo priti edhe kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Takimet e Merkelit janë në kuadër të përgatitjeve për

Samitin e Ballkanit me BE-në në Sofje të Bullgarisë, i cili do të zhvillohet më 17 maj, si dhe për konferencën e Londrës në korrik të këtij viti, që bëhet në kuadër të ashtuquajturit "Proces të Berlinit". Në të dyja këto takime të nivelit të lartë do të konsolidohet strategjia e afrimit të rajonit me Bashkimin Evropian.

Vizita e Hashim Thaçit në Berlin është vizitë pune dhe jozyrtare. Vizita e tij zyrtare si president i Kosovës, në kuadër të së cilës do të takohet me homologun e tij, është shtyrë gjatë këtyre muajve për shkak të vonesave për krijimin e Qeverisë gjermane dhe pritet të zhvillohet gjatë muajve të ardhshëm.



Reshitaj në Stamboll, Kosova faktor stabiliteti e paqeje në rajon

STAMBOLL, 6 MAJ (ER) - Ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare "Connectivity: Road to Peace", e cila është mbajtur në Stamboll. Para përfaqësuesve të lartë shtetërorë, Reshitaj ka thënë se Pavarësia e Kosovës ka krijuar stabilitet dhe paqe në rajon. Ajo ka falënderuar Turqinë dhe Pakistanin për mbështetjen që po ia japin Kosovës si bashkorganizatore të

kësaj konference.

Reshitaj ka theksuar rëndësinë e krijimit të strategjisë së përbashkët për politikën mjedisore në gjithë rajonin. Ministrja Reshitaj fjalën e saj e mbylli duke cituar Mahatma Gandhin: "Nuk ka rrugë për paqe. Paqja është rruga".

Gjatë prezantimeve në këtë konferencë u rikonfirmua përkrahja e shteteve të lindjes për Kosovën në zhvillimin e saj dhe njohjen nga shtetet që ende s'e kanë njohur.

Në këta sektorë shprehin interesim ndërkombëtarët

PRISHTINË, 6 MAJ - Sektori energjetik, miniera, transport dhe telekomunikacion, industria përpunuese dhe turizmi janë vetëm disa nga sektorët me më potencial të përcaktuar nga Qeveria e Kosovës, në të cilët investitorët ndërkombëtarë do të mund të investonin.

Zhvillimi i këtyre sektorëve, sipas përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës, po konsiderohet mundësi e rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar.

Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit Ramush Haradinaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se investimet e huaja janë gati e vetmja mundësi për t'i zgjidhur problemet si

papunësia, varfëria e problemet e tjera sociale. "Meqenëse potenciali ekonomik është i përkufizuar, ne e shohim si shans të mirë ardhjen e investitorëve të huaj dhe përmes tyre të plotësohen mangësitë që kemi, pasi që forca akumuluese e ekonomisë sonë është e ulët për të investuar për atë që ka nevojë dinamika që kërkohet për t'i zgjidhur problemet ekonomike që ka vendi. Sektorët me prioritet janë sektorët strategjikë në energji, në miniera e minerale, në bujqësi, në turizëm, transport e telekomunikacion dhe fusha të tjera", ka thënë Shatri.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka deklaruar për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova ka potencial të madh në sektorë të shumtë për investitorët

ndërkombëtarë dhe të brendshëm. Por, sipas tij, ai potencial po vazhdon të mbetet i pashfrytëzueshëm. "Në fakt, aty ku institucionet tona kanë dështuar gjitha këto vite është në ndërtimin e një brendi shtetëror nacional të Kosovës. Investitorët përgjithësisht pak dinë për Kosovën dhe atë njohuri që e kanë për Kosovën e lidhin me imazhet e luftës, por jo me gjithçka që sot ofron vendi. Sot Kosova ofron legjislacion modern që është në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Edhe ofertën e tyre për tërheqje të investitorëve e ka të pasur, ka një sistem të mirë tatimor dhe të krahasueshëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe ka lehtësira që mund t'u ofrohen investitorëve, por në mungesë të njohurive për brendinë tonë, ato

mbesin të pashfrytëzuara", ka theksuar Zeka.

Edhe pse investimet e huaja vazhdimisht vlerësohen si mjete të domosdoshme për zhvillimin ekonomik, këto investime kanë shënuar rënie përgjatë viteve në Kosovë. Derisa në vitin 2008 investimet e huaja ishin 355 milionë euro, në vitin 2017 investimet e huaja nuk ishin më shumë se 280 milionë euro.

Të pakënaqur me nivelin e investimeve shprehen edhe përfaqësues të Qeverisë së Kosovës. Haki Shatri thotë se janë duke bërë përpjekje që t'i tërheqin investitorët përmes Ligjit për investime strategjike, i cili ka ndarë edhe sektorët potencialë dhe presin rritjen e nivelit të këtyre investimeve. "Për fat të keq, në vitet e fundit, ndoshta për shkak sundimit të rendit dhe

ligjit, investitorët sikur janë rezervuar që të vijnë në Kosovë. Vëllimi i investimeve të huaja nuk është duke u rritur në nivelin që ne dëshirojmë dhe nuk është i mjaftueshëm. Nuk jemi të kënaqur me këtë dinamikë. Jemi duke bërë përpjekje të dëshmojmë para investitorëve se në këtë vend ka disiplinë", ka thënë Shatri.

Sipas Ligjit për Investime Strategjike, vëllimi i investimit për ta fituar statusin e investimit strategjik është nga 10 milionë deri në 30 milionë euro, varësisht nga sektori. Prioritet për përzgjedhjen e projekteve për ta fituar statusin e investimit strategjik, sipas këtij ligji, u jepet projekteve me vëllim më të madh investimesh dhe të cilat gjenerojnë më shumë vende pune.



Monedha euro vazhdon të bjerë



Tiranë, 6 maj - Në tregun e këmbimit valutor, monedha e përbashkët evropiane është zhvlerësuar sërish, duke u këmbyer në nivelin më të ulët në dhjetë vjet.

Arben Malaj, profesor i ekonomisë, ka pohuar për "Tv Klan" se rënia e monedhës në ditët e fundit nuk lidhet me faktorë fundamentalë, si:

importet, eksportet dhe investimet e huaja sesa me lëvizjet financiare në tregun e brendshëm të kompanive që operojnë në Shqipëri.

Për ekonomistin Malaj është e rëndësishme që askush të mos veprojë në panik, kurse i pyetur nëse do të ketë një stabilizim të mëtejshëm të kursit të këmbimit, ai sqaron se kjo është më

e vështira për t'u matur.

Leku në Shqipëri ka vazhduar edhe gjatë dy ditëve që lamë pas të dalë mbi të gjitha monedhat e tjera, duke thelluar rënien edhe të dollarit edhe të paundit britanik. Ndërkohë që në tregjet ndërkombëtare, dy valutat kryesore, euroja dhe dollari, vazhdojnë të jenë stabile.

Normat e interesit për depozita, ulje drastike



Normat e interesit në depozita kanë shënuar ulje drastike nga 3.5 për qind sa ishte para vitit 2014, në 0.04 për qind. Kështu bëhet me dije në raportin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vlerësimin e tremujorit të katërt (TM4) 2017. Në këtë raport thuhet se normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare vazhdojnë të jenë në nivel mjaft të ulët (1 për qind në TM4 2017) krahasuar me periudhën para vitit 2014 (rreth 3.5 për qind)

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 MAJ - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka publikuar raportin për vlerësimin e tremujorit të sistemit financiar për tremujorin e katërt (TM4) të vitit 2017. Sipas këtij raporti, depozitat në sektorin bankar në Kosovë u rritën për 45.6 milionë euro në TM4, karshi tremujorit të njëjtë të vitit paraprak. "Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u rritën për 45.6 milionë euro në TM4 2017 kundrejt rritjes së shënuar në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak prej 108.4 mil-

ionë eurosh dhe shënuan vlerën prej 3.09 miliardë eurosh", thuhet në raportin e BQK-së. Sipas këtij raporti, rritja më e ngadalshme në kuadër të depozitave kryesisht reflekton zhvillimet në kuadër të depozitave për ndërmarrjet të cilat u zvogëluan për 63.7 milionë euro dhe zbritën në 3.9 milionë euro në TM4 2017. Sipas BQK-së, edhe depozitat për ekonomitë familjare u zvogëluan për 47.8 milionë euro në krahasim me TM4 2016 dhe shënuan vlerën prej 28.5 milionë eurosh në TM4 2017. "Këto zhvillime në kuadër të depozitave për ndërmarrje dhe

veçanërisht depozitave për ekonomitë familjare reflektojnë, ndër të tjera, normat e ulëta të interesit të aplikuara nga bankat në depozita. Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 42.8 milionë euro në TM4 2017 krahasuar me rritjen për 60.3 milionë euro në TM4 2016. Depozitat e afatizuara, të cilat janë më sensitive ndaj normave të interesit, duke marrë parasysh normat e ulëta të aplikuara nga bankat, u tkurën për 39.7 milionë euro krahasuar me TM4 2016, duke qëndruar në vlerë prej 6.6 milionë eurosh në tremujorin e

fundit të vitit 2017. Kurse depozitat e kursimit, që janë kategoria më peshën më të vogël në kuadër të depozitave, ishte e vetmja kategori që gjatë TM4 2017 shënoi rënie, duke u zvogëluar për 3.7 milionë euro gjatë këtij tremujori", është thënë në raportin e BQK-së. Sipas këtij raporti, normat e interesit në depozita, pavarësisht prej rritjes së lehtë në vitin e fundit, vazhdojnë të jenë në nivele mjaft të ulëta krahasuar me periudhat para vitit 2014. "Normat e interesit në depozita për ndërmarrje vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare. Në depozitat e ndërmarrjeve norma e interesit qëndroi në nivel prej 1.6 përqindësh në TM4 2017, një rritje për 0.1 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e katërt të vitit paraprak. Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e kursimit (0.4 për qind në TM4 2017 nga 0.2 për qind në TM4

2016). Normat e interesit në depozitat e afatizuara për ndërmarrje shënuan ngritje të lehtë, kurse ato të transferueshme mbetën në nivele të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar", është thënë në raportin e BQK-së, duke u shtuar se normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare vazhduan të jenë në nivel mjaft të ulët (1 për qind në TM4 2017) krahasuar me periudhën para vitit 2014 (rreth 3.5 për qind). "Normat e aplikuara në depozitat e ekonomive familjare në secilin tremujor të vitit 2017 janë të përafërta me tremujorët e tre vjetëve paraprakë (figura 16). Pra, norma e interesit në depozitat e transferueshme (0.002 për qind), të kursimit (0.2 për qind) dhe ato të afatizuara (1 për qind) në TM4 2017 janë të ngjashme me normat e aplikuara në TM4 2016, dhe pothuajse të pandryshueshme nga tre vjetët e fundit", është thënë në raportin e BQK-së.

Pas vërshimeve, Aliu viziton bizneset dhe objektet e banimit privat

Ferizaj, 6 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka dalë të dielën në terren për ta parë gjendjen në këtë komunë pas vërshimeve të shiut të përcjellë edhe me breshër. Uji ka depërtuar në bodrume të shtëpive, vendpunishte, salla fabrikash dhe biznese të tjera duke shkaktuar dëme në materiale dhe në vegla të punës. Kryetari Aliu ka pohuar se një situatë e tillë me reshje kaq të dendura të shiut nuk mbahet mend kaherë në Ferizaj. Ai ka thënë se dëmet e shkaktuara janë të mëdha, sidomos në veprimtarinë e bizneseve, kulturat bujqësore dhe objektet private të banimit. Aliu ka thënë se të gjithë mekanizmat lokalë të emergjencave janë aktivizuar që nga e shtuna dhe, sipas tij,

vazhdimisht ka raportime nga qytetarët për dëmet e pësuar, ku ekipet profesionale po zhvillojnë vizita, duke vlerësuar dhe evidentuar kështu në kohë reale dëmet e shkaktuara nga stuhia. Kryetari Aliu ka bërë me dije se në ditët e ardhshme, në bazë të raportimeve nga banorët e zonave të përmbytura dhe vizitave në terren, do të hartohet një raport i evidentimit të saktë të dëmeve që ka shkaktuar shiu në territorin e Ferizajt. Ai ka falënderuar punonjësit e ndërmarrjeve publike të cilët kanë qenë të angazhuar në operacionet e pastrimit të terrenit dhe hapjes së kanaleve kulluese, si dhe gjithë banorët e zonave të përmbytura për ndihmën që po ua japin ekipeve në terren për kthimin e normalitetit pas reshjeve të mëdha të shiut.



Brenda 55 ditësh përfundojnë punimet për zgjerimin e rrugës në hyrje të Prishtinës

PRISHTINË, 6 MAJ (ER) - Në hyrje të Prishtinës kanë filluar punimet për zgjerimin e rrugës nacionale N25.2, segmenti në hyrje të Prishtinës.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, me bashkëpunëtorë, i shoqëruar edhe nga kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë inauguruar fillimin e punimeve në këtë rrugë, e cila do ta lehtësojë shumë trafikun në këtë pjesë të Prishtinës. Me këtë rast, ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka bërë me dije se kudo që ka kërkesa, së bashku me kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, do të jenë në shërbim të qyte-

tarëve. "Deri më tash nuk ka ekzistuar një bashkëpunim i tillë mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Prishtinës. Jemi zotuar që bashkërisht t'i zgjidhim kërkesat sa i përket infrastrukturës. Mund të them se ky segment rrugor do të punohet me tërësinë e infrastrukturës nëntokësore, me instalimet e domosdoshme dhe me ndriçim, që kjo lagje të ketë ndriçim me standarde evropiane dhe shpresoj se edhe në të ardhmen me kryetarin të punojmë edhe në projekte të tjera, prandaj urime dhe e gëzofshin qytetarët", ka thënë Lekaj. Ndërsa kryetari i Prishtinës,

Shpend Ahmeti, duke e falënderuar ministrin Pal Lekaj dhe bashkëpunëtorët, për fillimin e punimeve të këtij projekti të rëndësishëm për qytetin, ka thënë se ky projekt do t'i shërbejë edhe unazës së madhe të qytetit, e cila është projekt trevjeçar dhe se kjo rrugë do ta ndihmojë jashtëzakonisht qarkullimin në këtë aks rrugor, që është tejet i ngarkuar gjatë tërë kohës.

Segmenti i rrugës nacionale N 25.2 do të jetë i gjatë 600 metra, me katër korsi dhe do të kushtojë 800 mijë euro, kurse punimet për zgjerim të këtij segmenti do të përfundojnë brenda 55 ditësh.

Musli Gucati, pretendenti kryesor për kryetar të Rinisë Demokratike në Skenderaj



SKENDERAJ, 6 MAJ (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është duke mbajtur procesin zgjedhor për të rinjtë në të gjitha komunat, por vëmendjen më të madhe është duke e marrë Dega e Skenderajt. Përderisa në Skenderaj shumë të rinj kanë shpallur kandi-

daturën e tyre për kryetar të Rinisë Demokratike të Kosovës (RDK), pretendenti dhe kandidati kryesor që po merr vëmendjen më të madhe për kryetar të Rinisë Demokratike në këtë komunë është Musli Gucati nga fshati Marinë. Musli Gucati është absolvent,

në prag të diplomimit në Fakultetin Filozofik në Departamentin e Historisë në Universitetin e Prishtinës. Ai nga viti 2015 është kryetar i studentëve të Historisë, gjeneratës (2015-2018), njëkohësisht është nënkryetar i Këshillit të Studentëve në Fakultetin

Filozofik.

Gucati është student i dalluar dhe energjik e mjaft aktiv si në Prishtinë, po ashtu edhe në Skenderaj. Në kuadër të procesit zgjedhor të PDK-së ai ka vendosur të jetë kandidat për kryetar të Rinisë Demokratike në Skenderaj.

Agron Kuçi rizgjedhet kryetar i Degës së AAK-së në Junik

Junik, 6 maj (ER) - Kryetari aktual i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, është rizgjedhur edhe për një mandat në krye të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në këtë komunë. Besimin për këtë mandat ai e ka marrë në Kuvendin e VIII të AAK-së në Junik. Në punimet e këtij Kuvendi të AAK-së ishte i

pranishëm edhe lideri i kësaj partie, njëherësh kryeministër i vendit, Ramush Haradinaj, i cili dha fjalë të mira për qeverisjen e Kuçit në këtë komunë. Haradinaj ka konfirmuar edhe përkrahjen e Qeverisë për Komunën e Junikut në projekte të ndryshme. Agron Kuçi për tri mandate radhazi i ka fituar

zgjedhjet në Komunën e Junikut për kryetar komune. Po ashtu, ai që nga paslufta e drejton Degën e AAK-së në Junik. "Jam shumë i nderuar për besimin e marrë në Kuvendin e VIII për drejtimin e AAK-së në Junik. Me Junikun bashkë në fitoret e radhës", ka shkruar Kuçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Zvogëlimi i pagave të punëtorëve të PTK-së nuk është shpëtimi i saj



Jakup KRASNIQI

Për ta shpëtuar Postë Telekomini e Kosovës (PTK) duhet shpallur se ajo ndërmarrje publike është në krizë të përgjithshme financiare,

menaxhuese, efikase, profesionale etj., tek pastaj duhet të planifikohen masat adekuate që duhet të merren për sanimin e gjendjes. Mbase masa e fundit që do të duhej të merrej ka qenë dhe do të ishte zvogëlimi i pagave të punëtorëve.

Hapi i parë që do të duhej të merrej në atë ndërmarrje publike profitabile (ishte), do të duhej bërë një analizë profesionale të të gjitha rrethanave (arsyeve) që e sollën në këtë gjendje PTK-në, së paku për dhjetë vjetet e fundit. Kur dihet

botërisht se kopili i saj, i krijuar nga brenda "Z-mobili" dhe ortakja e saj "Ipko", janë duke operuar me sukses dhe janë shumë fitimprurëse?! Pse PTK-ja me gjithë atë infrastrukturë që e ka, të sillet në këtë gjendje? Pra, kërkohet një incizim i përgjithshëm i gjendjes dhe deri më tani askush nuk është i interesuar për një gjë të tillë?

Po të bëhej një analizë profesionale, do të duhej dhe ku qëndron "suksesi" i Kosovës në Gjykatën e Arbitrazhit në raport me "Axos"-in. Pa dyshim se suksesi është i Arbitrazhit, i cili

ka vërejtur të metat e shumta që ka pasur ajo përpjekje e paligjshme për privatizim. Në kushte normale, shteti do të duhej ta hulmuntonte atë përpjekje për privatizim. Për këtë rast, më së paku do të duhej të lavdërohej ata që deshën ta shesin PTK-në, për çka nuk besoj se blerësi i vërtetë ishte "Axos"-i.

Do të duhej të bëheshin shumë veprime të tjera hulmuntuese, të evidentoheshin të gjitha shkaqet që e sollën këtë gjendje në PTK dhe masa e fundit që do të duhej të

merrej, do të ishte zvogëlimi i pagave të punëtorëve. Ndonëse, do të duhej edhe mënyra e punësimit të shikohet se si është bërë deri më tani dhe si po bëhet edhe tani? Një gjë do të duhej të dihej nga ata që duan të marrin përgjegjësi për të qeverisur a menaxhuar me pasurinë publike. Kërkohet që të dinë shumë, që të duan t'i kryejnë mirë e me dashuri punët, tek pastaj vijnë: përgjegjësia, përkushtimi, profesionalizmi dhe efikasiteti në qeverisje a menaxhim.

Ballkani Perëndimor, ka ardhur koha për të vepruar

"Ka ardhur koha për të vepruar në Ballkanin Perëndimor", titullohet raporti që katër veteranë të diplomacisë amerikane prezantuan në Institutin Amerikan për Paqen, në Uashington

Nga Aida CAMA

Titulli është alarmues. Edhe vendi është zgjedhur me qëllim. Institutin Amerikan i Paqes, USIP, ndodhet përballë Departamentit të Shtetit, pra është sikur t'u thuash zyrtarëve ulur në karriget e zyrave në anën tjetër të rrugës: hej, koha nuk pret sepse Ballkani Perëndimor është kthyer sërish në rajon me stanjacion dhe destabilitet për shkak të qeverisjes së dobët, ndikimeve nga jashtë dhe marrëdhënieve të tensionuara etnike e midis shteteve.

Raporti i shkruar për dy organizata amerikane të fokusuar në konfliktet ndërkombëtare, Institutin EastWest dhe Komitetin Nacional për Politikën e Jashtme amerikane, thekson nevojën imediate që Amerika dhe Bashkimi Evropian të veprojnë për të penguar destabilizimin dhe shpërthimin e mundshëm të dhunës në Ballkan.

Autorët Thomas Graham, Jonathan Levitsky, Cameron Munter, Frank G. Wisner mendojnë se ShBA dhe EU duhet të përmirësojnë strategjinë dhe të rigjallërojnë partneritetin.

Koha nuk pret

Ambasadori Wisner është i

shqetësuar për situatën në rajon. Progresi ka ngecur, në disa raste situata është përkeqësuar. Njerëzit duhet të tregojnë më shumë kujdes për situatën aktuale, sepse koha nuk pret. "Mënyra se si duhet vepruar me situatën në Ballkanin perëndimor njihet prej ne të gjithëve: integrimi gradual në NATO dhe BE". Ky vit është i rëndësishëm për Ballkanin me takimet e nivelit të lartë të BE-së, të NATO-s. Vendeve duhet t'u ofrohet një rrugë e besueshme dhe e arritshme e anëtarësimit në institucionet transatlantike. "Kjo rrugë nuk shihet ende", thotë Wisner.

BE-ja mbetet primare, roli i Amerikës është ai i katalizatorit. Ballkani është pjesë e Evropës dhe një Evropë e lirë dhe e plotë përmban edhe Ballkanin.

Këmbim terriresh Kosovë - Serbi?

Nga salla u shtrua pyetja për idenë e këmbimit të terrirove Kosovë - Serbi. Ambasadori Wisner, pranon që kjo ide është hedhur prej presidentit serb. "Nuk kemi zgjidhje tjetër përveç se të japim përgjigje me kujdes. Ideja e këmbimit të terrirove është një ide, së cilës nuk i ka ardhur koha ende. Dhe unë nuk mendoj se do t'i vijë

koha tani shpejt. Ka shumë çështje të tjera që duhen zgjidhur... Si për shembull Asociacioni i komunave serbe". Për drejtorin e Institutit EastWest, Cameron Munter, "edhe marrëdhëniet ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë luajnë një rol. Po ashtu krijimi i besimit social tek njerëzit".

Shqipërinë nuk e përmendi askush në takim, as nga folësit, as nga publiku. Por raporti sugjeron se formula për Shqipërinë është nxitja e reformave. "Kandidatë që më 2014-n për praninë në BE, Shqipëria ka pasur vështirësi në zbatimin e reformave për

fillimin e negociatave. ShBA duhet ta inkurajojë Shqipërinë për të shfrytëzuar shansin e ofruar për hapjen e negociatave", thuhet në atë raport.

Maqedonia me lajme të mira dhe jo të mira

Për Maqedoninë prioritet duhet të jetë praninë në NATO dhe në BE. "Amerika duhet të shfrytëzojë ndikimin që ka në nivelet më të larta të Maqedonisë dhe Greqisë, për të theksuar rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së emrit. Duke bërë bilancin e bisedimeve Maqedoni - Greqi,

ambasadori Wisner numëron lajmet e mira dhe ato jo të mira: "Sot, numri i çështjeve që duhet të zgjidhen midis Shkupit dhe qeverisë greke, është ulur shumë. Atmosfera e dialogut midis palëve është shumë e ngrohtë. Kryeministrat dhe ministrat e të dy vendeve merren vesh mirë. Ekziston mundësia që të gjendet zgjidhja. Por, duhen javë, për të mos thënë muaj të tërë deri sa palët të kenë pranuar një zgjidhje politike, e cila duhet zbatuar më pas". Plani që kanë diplomatët është ta bindin presidentin Trump se "Ballkani është i rëndësishëm". (DW)



Koreja Veriore: Bisedimet e paqes po kërcënohen nga 'provokimi' i ShBA-së

PHENJAN, 6 MAJ - Koreja e Veriut ka paralajmëruar Uashingtonin se pretendimi se Phenjani është detyruar të negociojë si pasojë e presionit të ShBA-së, rrezikon që gjendja në gadishull të kthehet "në pikën zero", përdërisa dy shtetet po përgatiten për një samit historik. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Koresë Veriore e ka akuzuar ShBA-në se me qëllim po e provokon Phenjanin, në përpjekje për ta minuar atmosferën e tanishme "të dialogut". "ShBA-ja me qëllim po provokon Korenë e Veriut,

në kohën kur situata në Gadishullin Korean po lëviz drejt paqes dhe pajtimit", citohet të ketë thënë zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Veriut. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe lideri verikorean, Kim Jong-un, pritet të takohen në javët e ardhshme. Trumpi më 4 maj ka thënë se data dhe vendi për samitin historik me liderin verikorean është caktuar, duke mos dhënë më shumë detaje. Përgatitjen për takimin e dy liderëve kanë arritur çastin, pas një samiti më 27 prill në mes të Kimit dhe pres-

identit të Koresë së Jugut, Moon Jaein, në Zonën e demilitarizuar në mes të dy Koreve.

Në këtë samit Kimi është pajtuar të marrë në sërë masash, që kanë për qëllim t'i përmirësojnë marrëdhëniet në mes të Veriut dhe Jugut dhe ka shprehur vullnetin e tij për të biseduar për denuklearizimin e Gadishullit Korean.

Trumpi ka sugjeruar se "presioni" i tij i madh, përmes një fushate me retorikë të ashpër dhe sanksione, kanë luajtur një rol kyç në bisedimet me Phenjanin. Por, zëdhënësi i



Ministrisë së Jashtme të Koresë së Veriut e ka paralajmëruar ShBA-në që të mos e

interpretojë vullnetin e Phenjanit për bisedime si shenjë dobësie.

Putini përgatit rizgjedhjen president

MOSKË, 6 MAJ - Vladimir Putini po përgatitet të rizgjidhet president i Rusisë për një mandat të katërt deri në vitin 2024 pasi ka qenë në drejtim të vendit prej 18 vjetësh si kryetar i shtetit dhe Qeverisë. I rizgjedhur në mars me 76.7 % të votave, ose rezultati më i lartë që prej ardhjes së tij në pushtet, Putini është pozicionuar më shumë se kurrë si njeriu i fortë i një Rusie që e ka rivendosur në rreshtin e parë në skenën ndërkombëtare, me koston e tensioneve në rritje me perëndimorët.

Me një rezultat shumë më të mirë nga kundërshtarët e tij, me një pjesëmarrje më të lartë sesa presidencialet e vitit 2012, ai falënderoi rusët, mbrëmjen e rizgjedhjes së tij dhe u shpreh se "në këtë fitore të gjerë shikon besimin dhe shpresën e popullit". Opozita dhe OJQ-të ruse folën për shumë parregullsi, mes të cilave bllokim të qendrave dhe votues të sjellë me autobusë nën presionin e punëdhënësve të tyre.

Ceremonia e betimit e Vladimir Putinit u parapri nga një seri manifestimesh kundër, të organizuara të shtunën në të gjithë Rusinë me thirrje të opozitarit kryesor në Kremlin, Aleksei Navalni. Këto grumbullime, që ishin ndaluar nga autoritetet, shpeshherë u shpërndanë me forcë dhe sollën mijëra arrestime përfshirë edhe vetë Navalnin.

I shpallur i paafte për të kandiduar për shkak të një dënimi për vepra penale që ai e quan një sajim nga Kremlin, Aleksei Navalni nuk arriti të garojë vetë në zgjedhjet presidenciale.



I rizgjedhur në mars me 76.7 % të votave, ose rezultati më i lartë që prej ardhjes së tij në pushtet, Putini është pozicionuar më shumë se kurrë si njeriu i fortë i një Rusie që ai ka rivendosur në rreshtin e parë në skenën ndërkombëtare, me koston e tensioneve në rritje me perëndimorët

Një ditë nga betimi i mëparshëm i Vladimir Putinit, më 6 maj 2012, një manifestim kundër Kremlinit në sheshin Bolotnaja në Moskë u karakterizua nga përplasja me policinë dhe shumë manifestues u dënuan më pas me punë në kamp.

Ulje e tensioneve

Nëse kreu i Kremlinit ka bërë deklarata shumë luftarake gjatë fushatës së tij elektorale, në të

cilën ai mburri kapacitetet e reja ushtarake të Rusisë dhe raketat bërthamore "të pamposhtme", ai garanoi pas rizgjedhjes së tij triumfuese se kërkon t'i reduktojë shpenzimet ushtarake në vitet 2018-2019 dhe refuzoi çdo garë armatimesh. "Pas aneksimit të Gadishullit ukrainas të Krimesë në vitin 2014, të përshëndetur nga shumica e rusëve dhe që rriti popullaritetin e Vladimir Putinit, që ishte i lartë, synimi i presidentit rus tashmë nuk është t'i

bashkojë Rusisë toka të reja, por të mundësojë që e gjithë bota t'i marrë parasysh interesat ruse dhe t'i pranojë pushtimet e saj", deklaroi analisti Dmitri Oreçkine. E goditur në vitin 2014 nga sanksionet perëndimore të paprecedenta për shkak të krizës ukrainase, Rusia u kundërvihet perëndimorëve në konfliktin sirian dhe për shkak të akuzave për ndërhyrje ruse në zgjedhjen e Donald Trumpit. Kjo përballje Lindje - Perëndim është thelluar

edhe më shumë që kur Londra akuzoi Moskën në mars se ka helmuar ish-agjentin e dyfishtë rus në Britani të Madhe, duke sjellë largim të diplomatëve rusë në të gjithë botën të cilave Rusia iu përgjigj me masa të njëjta.

Vladimir Putini i cilësoi këto akuza si një "asgjë e madhe" dhe diplomacia ruse si një "sajim" britanik.

Pas 2024-s?

Pas ceremonisë solemne të betimit në Pallatin e Madh të Kremlinit, Putini do të qëndrojë në krye të Rusisë deri në vitin 2024, vit kur ai feston 72-vjetorin. I pyetur mbrëmjen e rizgjedhjes së tij mbi një kandidaturë të mundshme pas fundit të këtij mandati, ai u përgjigj: "Ju po talleni! Çfarë duhet të bëjë? Të rri këtu deri 100 vjeç? Jo".

Përveç ndonjë ndryshimi kushtetues, Vladimir Putini nuk mund të jetë sërish kandidat në vitin 2024, pasi Kushtetuta ruse e ndalon të kandidohet për më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Sipas ekspertëve, presidenti rus mund t'i përdorë këto gjashtë vjet për të përgatitur një pasues. Por, për çastin, njeriu i fortë i Rusisë është ruajtur që të mos japë asnjë informacion mbi personin që ai mendon.

Sipas analistit Konstantin Kalatçev, një largim i parakohshëm i Putinit nuk përjashtohet. "Ai është i lodhur dhe ai e kupton se duhet të largohet ndërkohë që është në formë. Largimi i tij do të jetë i mirë dhe i papritur për të gjithë botën", theksoi Kalatçev.

Netanyahu takon Putinin javën e ardhshme

MOSKË, 6 MAJ - Zyra e kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, ka njoftuar se ai do të takohet me presidentin rus, Vladimir Putin, në Moskë, më 9 maj, për të biseduar për çështjet rajonale. Sipas zyrës së Netanyahu, takimi mes dy lid-

erëve do të zhvillohet në Kremlin, pasi kryeministri izraelit të marrë pjesë në paradën tradicionale të "Ditës së fitores" që shënon përvjetorin e fitores së Bashkimit Sovjetik ndaj Gjermanisë naziste.

Netanyahu i është bashkuar presidentit amerikan Donald Trump në thirrjet për t'i përmirësuar "të metat" e marrëveshjes bërthamore të Iranit e arritur më 2015.

Rusia, Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Britania

dhe Kina kanë nënshkruar këtë marrëveshje, që i mundëson Teheranit lehtësim të sanksioneve, në këmbim të frenimit të programit bërthamor.

Izraeli gjithashtu ka shprehur shqetësim me rritjen e pranisë

ushtarake të Iranit në Siri. Rusia dhe Irani mbështesin presidentin sirian Bashar al-Assad në luftën civile, ndërkaq ShBA-ja dhe Turqia mbështesin grupe të ndryshme të rebelëve që luftojnë kundër forcave qeveritare siriane.

Përvjetori i 20 i përvjetorisë

Artim Jashari, guerilasi urban i UÇK-së

Bedri TAHIRI

Artim Jashari lindi më 2 korrik 1974 në Mitrovicë. Ato vite të lirisë së rreme kjo familje kishte zbritur nga Prekazi i trimërisë, nga i cili shpirtërisht nuk u shkëput kurrë. I ati, Sejdiu dhe e ëma, Hajria (nga Buroja) patën pesë fëmijë: Meritën, Artimin, Venerën, Vlorën dhe Kastriotin. Por, Artimi veçohet prej të gjithëve. Ishte i shkathët, i zgjuar e, mbi të gjitha, temperament që kurrë nuk pajtohej me padrejtësinë. Si kureshtar i madh çdoherë pyeste dhe interesohej edhe për gjëra që nuk i takonin moshës së tij. Lodrat e fëmijërisë i kishte zëvendësuar me armë. Heroizmi dhe trimëritë e të parëve të tij me kohë e kishin bërë për vete, duke ia sforcuar atdhedashurinë deri në ideal jetësor. Mësimet fillestare dhe ato të mesmet i mori në vendlindje. Ishte nxënës i shkëlqyeshëm. Që në klasën e pestë kundërshtonte hapur mësimin e serbishtes. Atëbotë e kishte lexuar romanin e ndaluar të Adem Demaçit "Gjarpinjtë e gjakut" dhe shoqërohej vazhdimisht me Ramadanin, djalin e Çerkin Pecit, i cili vuante prapa grilave serbe, rrëfen kujdestari i tij, Hamdi Shtiti. Ngjarjet e '81-shit lanë gjurmë të pashlyera në shpirtin e tij liri-dashës. Në moshën 13 vjeçare mori pjesë në demonstratat e '89-s. Tek Ura e Gjakut, kur u vra Selman Vojvoda, iu plagos shoku i ngushtë, Enver Tahiri, të cilin nëpër flakë pushkësh e dërgoi deri në spital. Bashkë me Afrim Zhitinë organizuan demonstrata në të gjitha shkollat e mesme të Mitrovicës. Ishte i palodhur e i patundur. Kurrë nuk ndalej. Kur u helmuan nxënësit mblodhi 400 litra qumësht dhe ua dërgoi në spital. Pas mbarimit të shkollës së

mesme regjistroi dy fakultete: atë të Filologjisë (Dega Gjuhë dhe Letërsi Angleze) në Prishtinë dhe Fakultetin Xehitaro-Metallurgjik në Mitrovicë. Që në fillim u inkadrua në Lëvizjen studentore. Me cimerin e tij, Ardian Krasniqin, dhe me Bujar Dugollin nuk pushonin së vepruari. Sa e sa herë ishte në bisedë informative dhe në rrezik jete, por kot. Kurrë nuk i vajti mendja ta braktiste Kosovën. Këtë e dëshiron hasmi ynë, andaj mos luani nga trojet stërgjyshore!, porosiste vazhdimisht dhe i qante zemra për ata që iknin.

Nxënës i Hamzë Jasharit

Gjatë viteve 1995-96 u angazhua në Rininë Republikane të Kosovës. Mësues dhe ideolog i tij ishte Hamzë Jashari, pa të cilin s'bënte gjë. Ku i thonë bukës bukë e ujit ujë është tokë jona. Deri te Molla e Kuqe do ta çlirojmë, thoshte, dhe kur u vranë ca shqiptarë në Gostivar e Tetovë u përpoq të organizohej për t'u vajtur në ndihmë. Përfaqësuesit të zyrës amerikane në Prishtinë, z. Majkëll Mecelen i kishte thënë se serbët, posa t'u jepet shansi, do ta ndjekin tërë popullsinë shqiptare nga Kosova, rikujton shoku i tij, Hastret Bektashi. Koha ecte, djaloshi vraponte. Përherë e më i fortë. Tashmë në kuadër të PRSH ishin formuar grupe të armatosura gurilase me seli të Stacioni i Autobusëve në Mitrovicë. Mbaheshin ligjëratat e tuboheshin armë për çlirim përfundimtar të Kosovës së robëruar. Artimi me disa të tjerë ishin bërë edhe anëtarë të UÇK-së dhe vepronin me emra konspirativë. Natën e fundit të shtatorit 1997 ma mori veturën dhe vajti në Prishtinë për të marrë afishe, nis rrëfimin, qetë-qetë i ati, Sejdiu. Të



nesërmen, më 1 tetor i ka marrë 47 copë për t'i shpërndarë matanë Lumit të Bardhë. Kur po e ngjiste të 36-n, mu në xhamin e lokalit ku pinin policët serbë, e arrestojnë. Polici me nofkën "Rusi" e maltretoi sa s'bën, por ai nuk u lëkund fare, qëndroi si burrat. Posa e lirojnë vihet në krye të demonstruesve, edhe pse trupin e drobitur nga dajaku e mbante të lidhur me fasha. Pas arrestimit të Besim Ramës, Avni Klinakut, Asllan Selimit, Besnik Restelicës etj., edhe Artimi rrezikohet. Duhej vepruar edhe më me maturi e syçeltësi. Lidhja me Jasharët dhe qëndrimi maleve e sforconin edhe më karakterin e tij luftarak. Ngjarjet në Likoshan dhe në Qirez e rënduan në shpirt. Në varrimin e Dëshmorëve të Qyqavicës u paraqit me uniformën e UÇK-së. Ishte bërë ushtar i rregullt i Adem Jasharit. Më 4

mars erdhi në familje. Të nesërmen nisi beteja e lavdisë. Trimi kishte ngelur jashtë rrethimit. Nga Prekazi i Epërm përcillte betejën e dragonjve me kuçedrën shumëkrerëshe. Kur ranë legjendarët u betua se do t'ua merre hakun. Natë e ditë vriste mendjen dhe bënte plane. Në shtëpi kthehej rrallë e më rrallë. E shoqja, Sheribanja, rriste djalin e vogël, Endritin. Mjaft e dua Endritin, por edhe dhjetë Endrita do t'i jap për lirinë e Kosovës, i kishte thënë trimi një ditë së emës.

Buzëqeshja e ngrirë

Dhe vreri i mbledhur lëmsh, një ditë shpërtheu si krater vullkani. Ishte nata midis 5 e 6 majit 1998. Po shkoj në një detyrë të rëndësishme dhe, nëse bëjmë diçka do të dal në Prekaz, ndryshe kthehem shpejt! Kështu u tha në

shtëpi Artimi, duke futur automatikun kinez nën sqetull e duke i rrasur dy bomba gjatoshë në xhepa. Posa kishte kaluar mesnata, kur një rafal automatiku shkrepiti si rufeja dhe çau errësirën skëterrore. Vetura e policisë serbe u bë shoshë. Edhe një bombë fluturoi drejt saj, por nuk shpërtheu. Trimi kontrollon bishat që përpëlitshin si djajtë në fundin e ferrit dantesk.

-Një për bacë Shabanin!
-Një për komandant Adem Jasharin!
-Një për strategun, Hamzë Jasharin!
-Një për...

Sakaq, një krismë e vetme plagosi natën e trishtuar. O Zot! Plumbi tinëzar e kishte kapur keq djaloshin. Gjaku i lirisë skuqti asfaltin e zi. Ai nuk ndalej. Ashtu zvarrë u fut në shtëpinë e afërme të Rrahman Bekës nga Duboci. U përpoqën t'ia japin ndihmën e parë, por kot. Çdo gjë ishte vonë. Një buzëqeshje e ngrirë ia kishte ndritur fytyrën. Trëndafil i kuq, aty përbri, lotonte në heshtje. Shpirti i njomë mori krahët drejt Jasharëve të tjerë...

-Një gjë më dhimbset shumë, zhdukja e tri fletoreve të tij me poezi, shënime e një ditar, thotë e motra, Vlorë.

Sot, trupi i dëshmorit, pushon në Varrezat e Dëshmorëve në Shipol. Nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, nga Ministria e Mbrojtjes dhe nga dy fakultetet e tij ka marrë dekorata, falënderime e shumë mirënjohje. Por, më mirë se gjetkë, dëshira e tij për t'i parë të bashkuara të gjitha trojet shqiptare, shihet në hartën e latuar në lapidarin e ngritur në vendin e ngjarjes, të zbuluar më 6 maj 2002. Edhe rruga që kalon nëpër Iliridë (Tavnik) mban emrin "Artim Jashari".

Lavdi për jetë e mot!

Zeqir Fazliu, poet i ditëve tona

GJILAN, 6 MAJ - I madh e i vogël, gjilanas e më larg, e njohin Zeqir Fazliun (1943), poet e profesor. Ai jeton me vargje. Vargjet e tij janë plot poetikë të krijuara me "mëlmesa" të jetës. E njohin Zeqën si poet i ditëve tona. Urta, fjalëpakë, por vizionar i largët. Është reagues e rebel aty ku puqet vlera poetike, poezia. Është poet që ka shpirt të trazuar, i cili frymëzohet për aktualitetin e jetës, por edhe për dhimbjet e për dashuritë e njeriut në jetë. Kohën e fundit ky poet gjilanas po lë gjurmë të thella në letrat tona. Vargjet e tij janë prezantuar në disa antologji të lehtësisë. Poezinë e Zeqir Fazliut, poet gjilanas, e lexon në disa gazeta, si: "Kosova sot", "Nacional",

"Metafora" e revista e gazeta të tjera në shqip. Pse jo? Ai, në një rast, kur e kanë pyetur se si i vijnë frymëzimet për të shkruar vargje, i është përgjigjur: "Hartimin e vargjeve ia kam marrë dorën"! Lapsi i tij është i hollë dhe nuk ndalet... Dhe, ky "mjeshtër i dalluar i vargjeve poetik, para do dite botoi veprën e njëzet me radhë me titull: "Bulëzat e thanës". Një vepër kulmore e veprimtarisë së tij poetike.

Zeqir Fazliu i gëzohet shëndetit. Ai thotë se, kur e ke shëndetin, të tjerat "sende" vijnë pas. Zeqa shkruan e s'ndalet. S'ndalet dhe, puna e tij në artin letrar kurorëzohet. Ai gjerë më tani ka marrë disa çmime të ndryshme nëpër aktivitete letrare. Në vitin 2003



Zeqir Fazliu, poet i ditëve tona...

dhe 2018, ai ka është nderuar me katër çmime për art letrar. Po

ashtu, në vitin 2006, në Drenas, në "Sofrën Poetike", ka marrë tri çmime, në Besianë (Podujevë) ka fituar katër çmime. Në manifestimin "Lulëkuqet e prillit", në Kamenicë, ai ka marrë dy çmime në vitin 2012. Po ashtu, në vitin 2015, në "Vjeshtën letrare" në Komoran, është shpërblye me një çmim për poezi. Jo vetëm kaq.

Ai, si poet i dalluar i vargjeve, ka depërtuar në disa antologji me nam. Ditë më parë, ai është përfshirë edhe në Akademinë Evropiane të Arteve me poezinë "Shtatë ditë", i cili është i treti me radhë pre krijues nga Kosova. Ky është shembulli më i mirë i vlerave letrare, ku përfaqësohet edhe në këtë eveniment të rrallë Evropian.

Edhe Migena Arllati, studiuese e letërsisë, lidhur me poezinë e Zeqir Fazliut, ajo ka shtuar se, autori (Z. F.) është poet që di t'i këndoje kohërave e ngjarjeve, proceseve e ndodhive, emocionëve e dashurive" (f. 7). Tek ky poet gjilanas, si më parë, por edhe tash vërejmë traditën tonë të pasur, së cilës i këndon bukur dhe qartë. Bie fjala, poeti i këndon Gërmizë, Rugovës, Ulqinit Shëngjinit, Valbonës, Karadakut, Ibrit, Lumbardhit e mikrobtës që e freskon poezinë me drenushën, kanarinën, milingonat, sorkadhen, trumcakun, bilbilin pulëbardhën, dallëndyshen, të cilat simbolika e hijeshojnë atmosferën romantike dhe idilike të veprës së tij. /Tefik Selimi/

E rrallë

Dyqani më i pazakontë, 100 metra mbi tokë

Përkujdesja për nevojat e alpinistëve në Parkun Kombëtar Gjeologjik Shiniuzhai të Kinës është shoqëruar edhe me ngritjen e një dyqani për të shitur ujë dhe ushqime të lehta. I quajtur dyqani më i papërshtatshëm në botë, dyqani është i varur në mes të një shkëmbi të ndjeshëm në Pingjiang County më shumë se 100 metra mbi tokë.



BARSOLETA E DITËS



Nipi viziton gjyshen në shtëpinë e saj. Nipi: Gjyshe, qysh është pasvordi? Gjyshja: Besforti mirë është, sonte ka shkuar te daja i vet.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



FOTO E DITES



Gara me biçikleta nëpër rërë në Merzouga në Marok. /AFP/

Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min


Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



E jashtëzakonshme

Kapen 50 krokodilë në aeroportin e Londrës

Në aeroportin e Heathrowit të Londrës janë konfiskuar 50 krokodilë. Një prej krokodilëve kishte ngordhur. Ata ishin të destinuar për t'u dërguar në një fermë në Cambridgeshire, por tani janë nën kujdesin e zyrtarëve nga Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara (CITES).



49 krokodilët do të rikthehen në vendin e tyre.

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Sot do të jetë një ditë e mbarë për të gjithë të lindurit e kësaj shenje. Çdo dëshirë e juaja do të realizohet pa asnjë pengesë.



DEMI
Po punoni shumë me veten sot dhe me logjiken tuaj. Në të shkuarën ju kanë lënduar sepse keni ndjekur ndjenjat dhe jo arsyen.



BINJAKËT
Dita e sotme është plot ngjyra dhe buzëqeshje për ju. Ndihehi mirë me një finalizim projekti dhe do të jepni vetëm energji pozitive vërdallë.



GAFORRJA
Nëse shpresonit që një miqësi e mirë të kthehej në diçka më shumë, keni gabuar. Kjo gjë do t'ju dhembë, edhe pse nuk do të deklaroheni.



LUANI
Nuk duhet të tregoheni krenar dhe kur e kuptoni që keni gabuar. Të kërkonit falje do ta kuptoni që është gjëja më e thjeshtë për të bërë.



VI R G J Ë R E S H A
Përgatituni për një lajm të madh që do të merrni. Diçka që keni dëshiruar prej kohësh ka të gjitha premisat për t'u bërë realitet.



PESHORJA
Kjo stinë është e mbushur e gjitha me udhëtime. Janë gjëja që ju pëlqejnë më shumë dhe merrni shumë miq me vete nëse shkoni diku.



AKREPI
Edhe pse keni qenë mjaft xhelozë për partnerin kohët e fundit, gjithçka do të qetësohet sot. Një surprizë e këndshme do t'ju bashkojë në mbrëmje.



SHIGJETARI
Sot nuk do të kënaqeni me asgjë dhe do të keni komente për gjithçka që ju rrethon. Dikush mund të mos e pëlqejë këtë sjellje tuajën.



BRICJAPI
Keni qenë shumë të përdhelur në fushën sentimentale sot dhe kjo do t'ju ndihmojë të kaloni me qetësi çdo pengesë në karrierë.



UJORI
Jeni praktik dhe të pavarur dhe kjo gjë do t'ju karakterizojë përgjatë gjithë ditës së sotme. Asnjë nuk mund t'ju kushtëzojë nëse nuk doni të veproni.



PESHQIT
Sot nuk do të jetë një ditë e qetë dhe miqtë tuaj do të kenë mjaft për të thënë për ju dhe mënyrën se si po veproni kohët e fundit.

Cardi B po përballet me një problem gjatë shtatzënisë



Cardi B është shtatzënë dhe pret fëmijën e parë dhe është duke u përballur me një problem. Reperja 25-vjeçare ka postuar një status në "Twitter" në lidhje me "ëndrrat e frikshme", "ëndrrat seksuale" dhe "ëndrrat e

mira". "Mirë, një gjë që nuk më pëlqen në lidhje me shtatzëninë janë këto ëndrra të çuditshme, të çmendura, të frikshme që kam pasur. I urrej ato. Unë zgjohem në mes të natës duke mu dridhur buza", ka deklaruar Cardi.

Merr fund fejesa e çiftit të famshëm



Ka mbaruar lidhja e Steven R. McQueen dhe Alexandra Silva. Çifti i dha fund fejesës, raporton "Us Weekly". Steven ka zbuluar lidhjen e tij me Silva në

janar të këtij viti me anë të një fotografie bardhë e zi të çiftit duke u puthur. Lidhja e tyre u bë zyrtare në rrjetet sociale në dhjetor të vitit 2016.



Jordin Sparksi bëhet nënë

Këngëtarja Jordin Sparks dhe bashkëshorti i saj Dana Isaiah kanë mirëpritur në jetë fëmijën e tyre të parë së bashku. 28-vjeçarja lindi një djalë,

emri i të cilit është Dana Isaiah Thomas Jr. Jordin dhe Dana u martuan në korrikun e kaluar dhe shumë shpejt zbuluan se po prisnin një fëmijë.

Gwyneth Paltrow dhe Brad Falchuk nënshkruajnë marrëveshje paramartesore



Gwyneth Paltrow dhe i fejuari i saj Brad Falchuk kanë nënshkruar një marrëveshje paramartesore. Aktorja dhe producenti kanë menduar të marrin masa paraprake përpara se të martohen. Të dy kanë fëmijë

nga martesat e mëparshme ndaj e kanë konsideruar të nevojshme nënshkrimin e marrëveshjes. Marrëveshja mes Paltrow dhe Falchukit përmban disa pika që duhen respektuar gjatë bashkëjetesës.



CHENXING JIANG

Lindur në Singapor e rritur në Hong-Kong, Chenxing Jiang përkthen nga italishtja, gjermanishtja dhe kinezishtja në anglisht. Është përfituese e grantit të fondit të përkthimit të PEN-it dhe laureate e çmimit për përkthim, *Susan Sontag*. Shkrimet dhe përkthimet i janë botuar në *The Atlantic*, *The Guardian*, *The Nation* dhe *Words Without Borders*. Ajo po ndjek studimet për doktoratë në Komitetin për Mendimin Social në Universitetin e Chicagos. Përkthimi i saj i fundit, bestselleri ndërkombëtar *Lotët e kripës: Tregimi i një mjeku* i Bartolo Bartolos dhe Lidia Tilottas, është botuar në janar nga *W. W. Norton*.

FUQIA POLITIKE E PËRKTHIMIT

Kur Angela Merkel i hapi kufijtë për refugjatët në gusht të 2015-s, atë verë qëllon në Berlin. Për ditë të tëra vetëm shikoja lajme dhe lexoja për familjet siriane dhe refugjatët e tjerë që vërshonin stacionet gjermane të trenit. Një vit më vonë u zhvendosa në Berlin, e etur për të bërë çfarëdo qoftë si vullnetare për t'i mirëpritur refugjatët. Iu bashkova një klubi vullnetarësh me gjermanët e të huaj por, si fillestare, më shumë po u nxirrja telashe sesa që po i ndihmoja organizatorët. Bëra përpjekje të kota për ta mësuar arabishten prej një libri të *Living Language*. Kishte kohë të gjatë prej se isha marrë me përkthim librash dhe materiale arkivore dhe kështu nuk e kisha entuziazmin e dikurshëm. Kishte dhjetëra mija refugjatë vetëm në Berlin, kështu që çfarë mund të bënte një njeri i vetëm? Asnjëherë nuk më ka rastisur që puna ime si përkthyes veprash letrare, ndër të tjera, edhe nga italishtja në anglisht, të lidhej me kauza politike me të cilat merresha me të madhe.

Pastaj mora një letër elektronike nga një botues: a dëshiron të përkthesh një libër të shkruar nga një mjek italian që drejton një klinikë në ishullin Lampedusa, që ishte bërë vija frontale e përpjekjes humanitare për t'i shpëtuar refugjatët në rrugën e rrezikshme

drejt Evropës? Pa kaluar koha e mjaftueshme për ta lexuar librin, ia ktheva: "Po". Dhe kur e lexova *Tears of Salt (Lotët e kripur)* u mahnita edhe më shumë me prospektin e përkthimit të veprës. Bashkë me bashkautorin Lidia Tilotta, mjeku lampedusian, Pietro Bartolo, sjell dëshmitë e refugjatëve që i ka shpëtuar: familje të ndara dhe të ribashkuara, gra shtatzëna nga përdhunimet, fatkeqësi tragjike në det.

Bashkë me këto dëshmi është edhe rrëfimi i Bartolos së rritur në Lampedusa, si fëmijë i një familjeje të varfër peshkatarësh. Meqë ishulli nuk kishte shkollë të lartë, rioshi Bartolo u dërgua në Sicili për ta kryer shkollimin e lartë, që të kthehej pastaj në Lampedusa për ta drejtuar klinikën i vetëm. Pranimi i vendit të punës si mjek në një ishull të harruar, afërmendsh se është veprim politik, meqë ua ofron shërbimin mjekësor të gjithë anëtarëve të bashkësisë, edhe nëse ky mund të mos ishte motivi parësor i Bartolos. Për më tepër, kur numri i refugjatëve që po këpusnin Mesdheun mbërriti nivel krize, Bartolo e kuptoi se ishte përfshirë shpirtërisht në diskutimin politik për zotimet humanitare dhe identitetin e Evropës. Këto dilema janë edhe më të tendosura në

Lampedusa, port i vogël italian që gjeografikisht është më afër me bregun tunizian se me atë sicilian. Aty shkrihen kufijtë ndërmjet Evropës dhe Afrikës.

Nuk është e nevojshme të thuhet se edhe përkthimi letrar është në thelb veprim politik, asi që tekstet e veçanta ua ofron lexuesve të veçantë duke i zhvendosur përtej kufijve gjuhësorë. Përkthyesit shpesh avokojnë për autorë dhe libra që i përkthejnë, por nuk e marrim përherë të mirëqenë përkthimin si fushatë politike. Madje as që duhet ta mendojmë kështu; është e vërtetë se me kushtimin e vëmendjes një narrative sfiduese dhe intriguese, shprehim qëndrim politik çfarë e vlerësojmë, por ne nuk lexojmë ose përkthejmë libra të mirë vetëm për shkak të importimit politik si akt; ne i lexojmë sepse janë të mirë. Ne, thjesht, nuk mund të ndihmojmë.

Sipas kësaj logjike, sidomos disa libra zënë vend parësor në dimensionin politik të punës së përkthyesit për shkak të rëndësisë aktuale politike - dhe teksa po e mendoja këtë, e mora vesh se shpesh jam joshur prej tyre në të kaluarën. Libri i parë që e kam përkthyer ishte një ditar i revolucionit kulturor kinez, një episod jashtëzakonisht dramatik që kishte kapluar shkollat kineze

anëmbanë dhe ishte adresuar sipërfaqësisht në Hong-Kong, ku jam rritur. *Stalla e lopëve* e Ji Xianlini, ditari më i lexuar sipas të gjitha gjasave për revolucionin kulturor në vet Kinën, mendoja se duhet t'u ofrohej edhe lexuesve të anglishtes. Ama, mund ta kishin në duar vetëm nëse do t'u përkthehej.

Dhe bashkë kjo është puna e përkthimit: e ofron perspektivën e një mjeku italian për Lampedusën - një histori në të cilën vetë dialogu përkthehet nga arabishtja dhe sicilianishtja - që të mund ta lexojnë lexuesit në Newcastle apo New Mexico. Në *Lotët e kripur*, Pietro Martolo vë në pah atë çfarë mendon se është zgjidhja e drejtë për dilemën humanitare të Evropës, marrë parasysh se krizës së emigrantëve të dëbuar dhunshëm nuk po i shihet fundi. Nuk është se pajtohem me veprën në tërësi, por kjo nuk ka rëndësi: çfarë ka rëndësi është fakti se nëpërmjet versionit anglisht të *Lotëve të kripur*, perspektiva e autorit bëhet pjesë e diskutimit për mënyrën e reagimit të shteteve mikpritëse të refugjatëve. Vendet anglishtfolëse kanë relativisht pak refugjatë krahasuar me shifrat e panjohura të atyre që kanë hyrë nëpër shtetet evropiane kontinentale, lëre më numrin jashtëzakonisht të lartë të atyre që janë vendosur në Jordani ose Turqi,

andaj është me rëndësi të veçantë të mbahet gjallë debati për këtë çështje.

Gianfranco Rosi, regjisori italian i shpërblyer për *Zjarr në det*, që dokumentoi punën e Bartolos në Lampedusa, ka thënë për filmin: *Dua që njerëzit ta shohin filmin që pastaj të thonë: 'Çfarë qëndrimi kam për këtë çështje? Çfarë mund të bëjë?'* Afërmendsh se kjo është dilemë që shtrihet prej një libri a filmi - derisa shpresoj se narrativa e fuqishme e *Lotët e kripur* provokon reagim të lexuesve dhe nuk kam ndonjë qëllim të programuar se çfarë mund të arrijë vepra. Mbase përkthimi i fjalëve të Bartolos dhe Tilottas do t'ia mbushë mendjen një lexuesi kudo qoftë se nuk mund t'ia dalë me mësimin e arabishtes por, në vend të kësaj, t'i bashkohet ndonjë grupi vullnetarësh e refugjatësh, ose edhe të gjejë ndonjë shteg praktik ku mund të ndihmojë. Mbase do ta ndryshojë mendjen e disa lexuesve dhe do ta përndritë atë të disa të tjerëve. Por edhe nëse *Lotët e kripur* nuk i nxit drejtpërdrejt lexuesit që të hidhen në aksion, zëri i Bartolos mund të dëgjohet tani edhe me përkthimin e veprës në anglisht, dhe kjo nuk është pak punë.

(Marrë nga revista "Akademia".
Përktheu nga anglishtja: Rexhep Maloku)

GOGOLI

Inxhinieri Roberto Paudi, asistent i drejtimit të Com-Prax dhe këshilltar i urbanistikës, u inatos pa fund kur një mbrëmje dëgjoi dadon Ester e cila, për të zbutur një tek të djalit të vogël, Frankos, i tha:

- Shiko se, po u solle keq, natën ka për të të ardhur Gogoli.

Ishte e patolerueshme, sipas tij, që për t'i edukuar fëmijët të përdoreshin ende këto besëtytni që mund të ngjallnin në psikikën e njomë, komplekse të përveuajtura. Kështu e qortoi vajzën e cila u largua e përplotur, e iu desh atij vetë të vinte në gjumë të birin i cili shumë shpejt u qetësua.

Të njëjtën mbrëmje, Gogoli, duke shkelur me majat e gishtave ajrin, siç e kishte zakon të lëvizte, u shfaq në dhomën ku inxhinier Paudi po flinte i vetëm, duke i ngjallur disa minuta drithërim.

Gogoli, siç dihet, merrte në varësi të vendeve dhe të zakonave lokale, forma të ndryshme. Në atë qytet, prej kohësh të hershme, mbante format e një kafshe gjigante me gjyrë të errët, hija e të cilit luhate midis hipopotamit dhe tapirit. I tmerrshëm në pamje të parë por, nëse vëzhgohej me kujdes, vihej re, nga përthyerja e butë e gojës dhe nga shkëlqimi gati i dashur i veshtrimit, një shprehje që mund të ishte gjithçka, përveçse e keqe.

Vetëkuptohet se në rrethana të njëfarë rëndësie dinte të ngjalle të dridhura ose edhe frikë, por zakonisht i çonte në fund ndërhyrjet e tij, me takt. Kur i avitej kreatit të fëmijës që do të ndëshkohen, as nuk e zgjonte fare, por depëronte në ëndrrat e tij ku linte një gjurmë të përthyerje. E dimë mirë, në fakt, se edhe ëndrrat e vogëlueshëm të vegjël kanë një hapësirë të pakufizuar dhe pranojnë pa problem edhe krijesa vigane si Gogoli të cilët mund të kryejnë të gjitha veprimet e rastit në liri të plotë.

Natyrisht se kur iu shfaq inxhinier Paudit, krijesa antike nuk kishte një pamje shumë dashamirëse, por mbante fizionominë, kuptohet të stërmaduar, të profesor Galurios, i emëruar prej dy muajsh si komisar i jashtëzakonshëm i COMPRAX-it, shoqëri që po notonte në ujëra të vështira. Dhe ky profesor Galurio, njeri tejet i ashpër, në mos po i pakomunikueshëm, qe pikërisht frika më e madhe e Paudit, pozita e të cilit në ndërmarrje, nën këtë situatë kontrolli, rrezikohet jashtëzakonisht.

Paudi, si u zgjua nën një petk djersësh të ftohta, arriti ta shohë në kohë vizitorin që po ia mbathte përmes murit (dritarja nuk do të kishte qenë e mjaftueshme për ato përmasa të mëdha), duke i treguar kupolën monumentale të të pasmeve të tij.

Mëngjesin tjetër Paudi as mori

mundimin t'i kërkonte ndjesë Esterës së gjoërë. Madje kur verifikoi personalisht se Gogoli ekzistonte vërtet, iu rrit, bashkë me përçmimin, vendosmëria e patundur për ta hequr me çdo kusht qafe këtë tipin.

Disa ditë më vonë, thuajse me shaka, ai i kërkoi mendim gruas, miqve, bashkëpunëtorëve. Dhe mbeti i habitur kur pa se ekzistenca e Gogolit përgjithësisht dihej nga të gjithë, si një ngjarje klasike e natyrës, sikundër shiu, tërmeti dhe ylberi. Vetëm doktor Xhemonio, i zyrës ligjore, mbeti pa mend kur e pyeti: po, i vogël pat dëgjuar të flitej nëpër mjegull për atë gjë, por pastaj ia mbushi mendjen vetes që ishte një përrallë kalamajsh pa thelb brenda.


Sikur ta dinte kundërshtinë e thekur të tij, Gogoli që nga ajo ditë filloi të frekuentojë me këmbëngulje të spikatur inxhinierin, gjithmonë nën maskën e pakëndshme të profesor Galurios, duke e përqeshur, i tërhoqte këmbët, e shkundte në shtrat, e një mbrëmje arriti aty sa iu kruspullua në gjoks e, për pak, nuk i mori frymën. S'ka për t'u habitur atëherë nëse Paudi, në mbledhjen e radhës të Këshillit Komunal, e bisedoi me disa kolegë: a mund të lejohej në një metropol që mburret të ishte në pararojë, përsëritja e një maskarallëku të tillë, i denjë për Mesjetën? A nuk ishte rasti të zgjidhej përfundimisht kjo punë, me mjetet e përshtatshme?

Në fillim lindën pëshpërimita korridore, shkëmbime joformale pikëpamjesh. Thënë shkurt, reputacioni që gëzonte inxhinier Paudi i hapi rrugën. Nuk kaluan as dy muaj kur problemi mbërriti në Këshillin Komunal. Quptohet vetiu, për ta shmangur qesharaken, që rendi i ditës nuk e zinte goje Gogolin, por në nënin 5 përmendte vetëm një "fakt të turpshëm shqetësimi për qetësinë mbrëmësore të qytetit".

Ndryshe nga ajo çka priste Paudi, jo vetëm se argumenti u prit seriozisht nga të gjithë por, teza e tij, që mund të tingëllonte së largu e qartë, ndeshi kundërshtitë të forta. U ngritën zërat në mbrojtje të kësaj tradite sa të padëmshme aq dhe piktoreske, që lindte në agun e kohëve, duke nënvizuar sa i padëmshëm ishte në tërësi përbindëshi i natës, veç të tjerash, krejt i heshtur, si dhe duke zbuluar të mirat edukuese të pranisë së tij.

Pati nga ata që folën deri edhe për një "atentat ndaj trashëgimisë kulturore të qytetit", nëse nuk do të ndërmerreshin masa represive dhe oratori që e citoi u mbulua nga duartrokitjet.

Nga ana tjetër, në çështjen në fjalë, mbizotëruan në fund argumentet e pazezistueshme të të ashtuquajturit progres, që i përdor shumë shpesh për t'i shkatërruar fortesat e fundit të misterit. Gogoli



DINO BUZZATI

Dino Buzzati (16. 10. 1906 - 28. 1. 1972) ka qenë shkrimtar italian. Ka shkruar novela, tregime të shkurtra, poezi. Ka qenë edhe piktor dhe gazetar. Me botimin e novelës *Shkretëtira e tartarëve* u bë i njohur në gjithë botën. Buzzati lindi në San Pellegrino, Belluni, në vilën stërgjyshore të familjes. Mamaja e Buzzatit ishte veterinere me profesion, kurse babai profesor i drejtësisë ndërkombëtare. Buzzati ndoqi rrugën e të atit, pasi regjistroi studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Milanos. Por, edhe pse studio për drejtësi, nuk u bë as avokat, as prokuror, as profesor i juridikut. Në moshën 22-vjeçare e nisi punën e gazetarisit në gazetën "Corriere della Sera", në të cilën punoi derisa ndërroi jetë..

u akuzua që linte një gjurmë të pashëndetshme në shpirtat fëmijërorë, që ngjalle ndonjëherë makthe në kundërshtim me pedagogjinë zyrtare. Dolën në shesh edhe motivet e higjienës: po, është e vërtetë, përbindëshi i mbrëmjes nuk e bënte pis qytetin e as linte ndotje personale të asnjë lloji, por kush mund të garantonte që nuk ishte bartës i mikroabeve dhe i viruseve? Rreth tij, pastaj, nuk dihej asgjë konkrete mbi bindjet politike: si mund të përjashtohet që ndikimi i tij, në dukje aq i thjeshtë, në mos i rëndomtë, të mos fshihte përbrenda kërcënime shkatërrimtare?

Debatu në të cilin gazetarët nuk u lejuan, nisur nga delikatesa e temës, përfundoi në orën dy pas mesnate. Propozimi i Paudit u aprovua me një shumicë të ngushtë prej pesë votash. Për vënien praktike në jetë të tij u emërua një komision i posaçëm ekspertësh, i udhëhequr nga vetë Paudi.

Në fakt, ta deklaronte izolimin e Gogolit ishte një gjë, e tjetër gjë ishte eliminimi i tij. Pa dyshim se nuk mund të zihet besim në disiplinën qytetare të tij; aq më tepër që nuk dihej nëse ishte në gjendje ta kuptonte gjuhën e folur. As nuk mund të mendohej dot që të kapej dhe t'i dorëzohej Kopshut Zoologjik të qytetit: cili kafaz do të mund të mbante dot brenda një kafshë, nëse ishte kafshë, të aftë të

nostalgjike me disa kujtime të furishme fëmijërie?

Takimi ndodhi në një natë të acartë hënëplotë. Patrulla e vendosur në një kënd të errët të Sheshit "Cinquecento" e pikasi vagabondin tek çante ajrin, qetësisht, në 30 metra lartësi, i ngjashëm me një nëndetëse të vogël. Agjentët, me armët në duar, bënë përpara. Përreth nuk ndihej asnjë frymë tjetër. Kërcitja e shkurter e breshërive u dëgjua si jehonë shumë larg.

Skena ishte mjaft e pazakontë. Me ngadalë, Gogoli u vërtit rrotull vetes pa nxjerrë një pëshpërimë, e duke ngritur këmbët lart, u rrëzua ngadalë derisa preku dëborën. Aty mbeti i shtrirë, i palëvizshëm, përgjithmonë. Drita e hënës reflektohej mbi barkun e stërmadh, të tendosur, që shkëlqente si llamarinë.

- Diçka që do të preferoja mos e shihja për herë të dytë, - rrefeu më vonë tetar Kotafavi. Një pellg gjaku u zgjerua, në mënyrë të pabesueshme, poshtë viktimës, e zezë nën dritën e hënës.

U lajmëruan menjëherë me telefon ata të murgut për ta hequr tutje kufomën. Nuk mbërritën dot në kohë. Në ata pak minuta gjëja gjigante, ashtu si ndodh me tullumbacet e shpuara, u shfry hap e mbyll sytë, u katandis në një larvë të gjoërë, u shndërrua në një krimb të zi në të bardhën e borës, në fund edhe krimbthi u zhduk, duke u tretur në hiç. Mbeti vetëm pellgu i turpshëm i gjakut të cilin e fshinë para mëngjesit hidrantët e pastuesve të rrugës.

U hapën fjalë se në qiell, derisa krijesa po jepte shpirt, shkëlqente q një hënë, por dy. U fol që në gjithë qytetin, zogjtë e natës dhe qentë u ankuan përjavshëm shumë gjatë. U përsërit që shumë gra, të moshuara dhe fëmijë, të zgjuara nga një thirrje e errët, dilnin nga shtëpitë, të gjunjëzuara, duke u lutur për të gjorin. E gjithë kjo nuk është e provuar historikisht. Në fakt, hëna e vazhdoi pa tronditje udhëtimin e paracaktuar nga astronomia, orët kaluan rregullisht njëra pas tjetrës dhe të gjithë fëmijët e botës vazhduan të flinin të qetë, pa e imagjinuar që mikuarmlonzonjar kishte ikur njëherë e përgjithmonë.

Pat qenë shumë tepër delikat dhe i ëmbël nga sa e besonin të tjerët. Pat qenë i krijuar nga ajo substancë e pakapshme që vulgarisht quhet përrallë apo iluzion: megjithëse e vërtetë.

Vrapo, arratisu, vrapo, fantazi e mbijetuar deri më sot. E etur për të të zhdukur, bota civile të është qepur pas, nuk do të të japë më paqe.

(Marrë nga numri i dytë i revistës "Akademia". Përktheu nga italishtja: Eris Rusi)



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LEGANES - LEVANTE

GG

GRANADA - RAYO VALLECANO

GG

LAHTI - SJK

3+

Drita dhe Prishtina, fyt për fyt

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 MAJ - Skuadra e Dritës dhe ajo e Prishtinës po e zhvillojnë garën për titull fyt për fyt, pasi kanë shënuar fitore të dielën ndaj Lirisë dhe Gjilanit. Gara për titull pritet të vendoset në dy xhirot e fundit, pasi diferenca e pikëve në mes të këtyre skuadrave vazhdon të jetë tri pikë. Fitore të vlefshme kanë shënuar edhe Flamurtari që e mposhti bindshëm Vllazninë e Pozharanit dhe Vëllaznimi ndaj Llapit në ndeshjen e zhvilluar në Gjakovë. Të shtunën bars kanë luajtur dy skuadrat nga regjioni i Drenicës, Drenica dhe Feronikeli.

Drita - Liria 3-0

Skuadra e Dritës i është afruar edhe më shumë titullit, pasi e ka mposhtur të dielën Lirinë në Gjilan (3-0). Prizrenasit rezistuan vetëm në pjesën e parë, kur rezultati ishte 0-0, kurse në pjesën e dytë vendësit dominuan dhe shënuan tre gola për t'i arketuar pikët maksimale. Leutrim Kryeziu (52), Përparim Livoreka (78) dhe Haxhi Neziraj (84) shënuan golat e fitores për skuadrën e Dritës. Diferenca e skuadrës së drejtuar nga Bekim Isufi me "bardhekaltrit" vazhdon të jetë tri pikë.

Prishtina - Gjilani 2-1

Prishtina ka bërë një paraqitje të madhe në pjesën e dytë në ndeshjen kundër skuadrës së Gjilanit, pasi e ka përmbysur rezultatin 0-1, duke shënuar dy gola për rezultatin final 2-1. Mysafirët e drejtuar nga Alban Hyseni realizuan të parët në fund të pjesës së parë me anë të Edon Hysenit, kurse në pjesën e dytë kryeqytetasit, pas një presioni në drejtim të portës së Gjilanit, e barazuan rezultatin në 1-1. Autor i golit ishte Blend Baftiu (80). Dy minuta pa përfunduar ndeshja, Basit Khalid realizoi për rezultatin final 2-1. Në xhirot e radhës Prishtina i shkon Lirisë, kurse Gjilani e pret skuadrën e Drenicës nga Skenderaj.

Flamurtari - Vllaznia (P) 4-1

Flamurtari i Prishtinës përfundimisht e ka siguruar pozitën e barazhit për të mbetur në Vala Superligë, pasi pas fitores ndaj Besës, shënoi fitore edhe ndaj Vllaznisë së Pozharanit me rezultat 4-1. Në minutën e 23-t Orhan Miftari i sollí mysafirët në epërsi 0-1 por, pas katër minutave, Egzon Hyseni i barazoi shifrat në 1-1. Kuqezinjtë e Prishtinës



kaluan në epërsi në minutën 35-të, me golin e shënuar nga Almir Ajzeraj. Flamurtari e shënoi edhe golin e tretë në fund të pjesës së parë. Autor ishte Granit Ahmeti. Flamurtari në pjesën e dytë e realizoi edhe golin e katërt dhe të fundit në ndeshje, kurse pas kësaj ndeshje skuadra kuqezi e kryeqytetit ka grumbulluar 22 pikë, kurse Vllaznia mbetet në kuotën e 14 pikëve.

Vëllaznimi - Llapi 2-0

Vëllaznimi i Gjakovës, pas fitores ndaj skuadrës së Llapit (2-0), i ka shtuar edhe më shumë gjasat për t'i ikur zonës së barazhit. Pas pesëmbëdhjetë minutave lojë, Dardan Rugova shënoi golin e parë për kuqezinjtë, kurse dhjetë minuta më vonë Lorik Rudi shënoi për 2-0. Gola të tjerë nuk pati dhe Vëllaznimi u gëzua fitores së madhe, kurse tash kjo skuadër ka grumbulluar 42 pikë, kurse Llapi mbetet në kuotën e 48 pikëve.

Trepça '89 - Besa 2-0

Trepça '89 ia ka dhënë goditjen përfundimtare Besës së Pejës, duke u larguar nga Superliga. Mitrovicasit që janë ende kampionë, shënuan fitore me rezultat 2-0. Golin e parë Otto John e shënoi në minutën e 37 nga penalltia. I njëjti futbollist shënoi edhe golin e dytë në minutën e 56. 89-shi pas kësaj fitore pozicionohet në pozitën e tretë me 50 pikë, kurse Besa është e parafundit me vetëm 19 pikë.

Drenica - Feronikeli 0-0

Ndeshja ndërmjet Drenicës dhe Feronikelit, në xhirot 31-të të Superligës së futbollit të Kosovës, nuk ka dhënë fitues. Asnjëra prej

skuadrave nuk arriti ta gjejë rrugën e golit për 90 minuta. Skuadrat ndanë pikët duke barazuar kështu me rezultat prej 0-0. Në vendin e gjashtë Drenica ka 46 pikë, me Feronikelin një pozitë më poshtë me 44 pikë.

Vala SUPERLIGA

Drita-Liria	3-0
Prishtina-Gjilani	2-1
Flamurtari-Vllaznia (P)	4-1
Vëllaznimi-Llapi	2-0
Trepça '89-Besa	2-0
Drenica-Feronikeli	0-0

Tabela

1. Drita	63 pikë
2. Prishtina	60
3. Trepça '89	50
4. Llapi	48
5. Liria	47
6. Drenica	46
7. Feronikeli	44
8. Gjilani	44
9. Vëllaznimi	42
10. Flamurtari	22
11. Besa	19
12. Vllaznia	14

Në dy xhirot e fundit takohen:

Java e 32-të

Drita-Trepça '89	
Liria-Prishtina	
Gjilani-Drenica	
Feronikeli-Vëllaznimi	
Llapi-Flamurtari	
Vllaznia (P)-Besa	

Java e 33-të

Trepça '89-Vllaznia (P)	
Besa-Llapi	
Flamurtari-Feronikeli	
Vëllaznimi-Gjilani	
Drenica-Liria	
Prishtina-Drita	

LIGA E PARË

Balkan-2 Korriku	2-1
Bashkimi-Onix	2-1
Hajvalia-Vushtrria	1-7
Kika-Trepça	3-2
Ramiz Sadiku-Fushë-Nosova	2-1
Rahoveci-Ferizaj	2-0
Nosova (P)-Dukagjini	1-1
KEK-u-Vitja	1-0

Tabela

1. Balkani	63 pikë
2. KEK-u	62
3. Vushtrria	59
4. Ferizaj	50
5. Onix	44
6. Fushë-Nosova	44
7. Bashkimi (K)	36
8. Ramiz Sadiku	35
9. Vitja	35
10. Dukagjini	33
11. 2 Korriku	33
12. Trepça	32
13. Rahoveci	30
14. Kika	30
15. Hajvalia	26
16. Nosova (P)	9

SHKURT

Nuhiu shënon tre gola ndaj Norwicht

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Atdhe Nuhiu, vazhdon të shënojë me klubin e tij, Sheffield Wednesday, në Championship. Në minutën e 14-t, pas një krosimi nga e majta, Nuhiu realizon një gol spektakolar me kokë, duke kaluar në avantazh skuadrën e tij, në përballjen ndaj Norwich City. Nuk është mjaftuar vetëm me një gol, pasi në minutën e 60, 28-vjeçari ka përfutuar nga një gabim i portierit, duke shënuar edhe golin e dytë personal, ndërsa në minutën e 4-t shtesë të pjesës së dytë, Nuhiu shënoi edhe golin e tretë në fitoren 5-1. Me tre golat e shënuara të dielën, Nuhiu arrin në kuotën e 11 golave në kampionat.

Samadrexha mbetet në Superligë

Hendbollistët e Samadrexhës edhe në edicionin e ardhshëm do të garojnë në Superligën e Kosovës në hendboll. Samadrexha kampionatin e përfundoi në pozitën e parafundit (9) në Superligë dhe për ta ruajtur statusin e anëtares së ligës elitare, është dashur ta fitojë ndeshjen e plejautit. Këtë e bëri të dielën në mesditë në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Në ndeshjen e plejautit, Samadrexha e mposhti Dukagjinin e Klinës me rezultat 28:22. 12:8 ishte rezultati pas pjesës së parë. Te Samadrexha më efikas ishte M. Jashari me tetë gola. Nga gjashtë herë shënuan D. Basholli e A. Maloku. Te Dukagjini u dallua Muqolli me 11 gola. Nga Superliga është larguar Llapi, ndërsa në Superligë ka kaluar Drenica. Drenica doli kampione në Ligën e Parë.

Haradinaj: Sportistët, ambasadorët më të mirë të paqes

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se sportistët janë ambasadorët më të mirë të paqes që, sipas tij, "kapërcejnë dallimet politike dhe etnike". Këto komente Haradinaj i bëri gjatë një takimi me kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani dhe kryetarin e Federatës së Karatesë së Kosovës, Ismet Krasniqi. "Qeveria mbështet sportistët në çdo garë rajonale dhe botërore, duke e vlerësuar lart rolin e tyre të afrimit, të promovimit të paqes. Ne jemi me fat që shumë sportistë tanë kanë kapërcyer kufijtë dhe jo vetëm kaq, kanë shënuar histori në një vend të huaj, duke përfaqësuar vlerat tona dhe duke na afruar më shumë me popuj të tjerë", ka deklaruar Haradinaj. Ekipi i karatesë së Kosovës do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian, që këtë vit mbahet nga 9 deri më 13 maj në Novi Sad të Serbisë. Në këtë kampionat Kosova do të përfaqësohet me 13 kateiste. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për përgatitjen e sportistëve të Kosovës për Lojërat e ardhshme Olimpikë "Tokio 2020".

Federata e Bodybuildingut dhe Fitnessit, e suksesshme në Spanjë

Në Santa Susanna të Spanjës është mbajtur Kampionati Evropian IFBB me një pjesëmarrje të 44 shteteve në kategori të ndryshme. Federatën e Bodybuildingut dhe Fitnessit të Kosovës e ka përfaqësuar sekretari gjeneral Sabri Dragusha, kurse kanë garuar Edona Luta në kategorinë Woman Body Fitness, e cila ka zënë vendin e pestë, dhe Besard Maxharraj në Bodybuilding +100 kg, i cili ka zënë vendin e katërt. Dragusha këtë rezultat e ka konsideruar si fitore të madhe të sportistëve të Kosovës, kurse për këto rezultate ka uruar federatën me kryetarin e saj, Esat Latën dhe gjithë Kosovën.

Lokomotiva, kampione pas 14 vjetësh

MOSKË, 6 MAJ - Lokomotiva e Moskës ka arritur të shpallet kampione në Rusi. Kjo pritje kishte zgjatur plot 14 vjet për tifozët e kësaj skuadre, pasi titulli i fundit ishte festuar në

2004-n. Rivalët e Zenitit nuk ia kanë dalë këtë sezon edhe pse kanë shpenzuar shumë dhe kanë një trajner të superpaguar siç është Roberto Mançini, i cili, sipas gjasave, në fund të

sezonit do ta marrë timonin e kombëtares së Italisë. 1 javë para fundit Lokomotiva ia ka dalë të festojë edhe matematikisht. Vendi e dytë e zuri Spartaku i Moskës, ndërko-

hë në vendin e 3-të është Krasnodari. Zeniti i Mançinit është "kënaqur" me vendin e pestë, që do të thotë vetëm një pjesëmarrje në Ligën e Evropës.



Ferguson, në terapi intensive pas operacionit

MANCHESTER, 6 MAJ - Sir Alex Ferguson është ende në gjendje kritike për jetën, 12 orë pas operacionit të kryer në tru, për shkak të një hemorragjie cerebrale që ka pasur mbrëmjen e 5 majit. Trajneri legjendar i Manchester Unitedit, tashmë 76 vjeç, ndodhet ende në spital nën mbikëqyrjen e mjekëve, ndërkohë që e gjithë bota e futbollit lutet e shpreson për rikuperimin e tij. Edhe pse ende nuk ka dalë një buletin mjekësor në lidhje me gjendjen e Fergusonit, mediet britanike konfirmojnë se situata nuk është e mirë, por mjekët po bëjnë të pamundur për ta shëruar.



"The Sun" shprehet se familjarët e trajnerit janë të shqetësuar për gjendjen dhe lutet që Sir Alexi ta kalojë këtë problem, ndërkohë që kërkojnë edhe ruajtjen e privatësisë dhe evitimin e deklaratave të gabuara në lidhje me gjendjen e ikonës së futbollit britanik. Mediet britanike konfirmojnë që Ferguson ndodhet në sallën e reanimacionit në terapi intensive, ndërkohë që operacioni ka shkuar

mirë, por trajneri ka nevojë për një periudhë të pacaktuar kurimi. Urimet për një shërim të shpejtë nuk kanë munguar për këtë ikonë të futbollit botëror. Ferguson u largua nga detyra e trajnerit të Manchester Unitedit në vitin 2013, pas 26 vjetësh në drejtimin e "dijve të kuq", ku fitoi 13 tituj kampionë, 5 Kupa të Anglisë, 4 Kupa të Ligës, 2 Liga të Kampioneve, 1 Kupë të Kupave, 1 Botëror për skuadra, 1 Superkupë të Evropës, 1 Kupë Interkontinentale dhe 10

Community Shield. Ndërkohë që, Sir Alexi ka fituar edhe tre kampionate në Skoci, 4 Kupa të Skocisë dhe një Kupë të Ligës në vendlindjen e tij. Trajneri pati probleme shëndetësore teksa ndodhej në shtëpinë e tij në Wilmslow, më pas u transportua me urgjencë në spital me autoambulancë. Ai u transferua nën shoqërimin e forcave të policisë në spitalin e "Salford Royal Hospital", ku dhe ndodhet nën mbikëqyrjen e mjekëve dhe kujdesin e familjarëve.

James ndëshkon sërish Toronton

OHIO, 6 MAJ - Cleveland Cavaliersi dhe Boston Celticsi vetëm një fitore larg kualifikimit në finale të Konferencës së Lindjes në NBA, duke e çuar në 3-0 serinë e gjysmëfinaleve, respektivisht ndaj Toronto Raptorsit dhe Philadelphia 76ers. Në "Quicken Loans Arena" të Clevelandit, Cavsi fitoi 105-103 ndaj Raptorsit, ku skenën e rrëmbeu i zakonshmi LeBron James me 38 pikë, 7 asistime dhe 6 rikuperime. Finalistët e sezonit të kaluar imponuan ritmin që në periudhën e parë, duke marrë kryesimin që në start, për të shkuar deri plus 17 pikë në fillim të periudhës së tretë, por kanadezët reaganuan me dinjitet në periudhën e fundit, duke arritur të barazonin 103-103 falë trepikëshit të Anunoby, tetë sekonda para rënies së sirenës për përfundimin e kohës së rregullt. Por, kur fatin e ndeshjes e merr në dorë "Mbreti" James, askush nuk mund ta ndalë. LeBroni nisi aksionin e fundit nga gjysmëfusha e tij, futet në zonë dhe lëshon një trajektore të lartë që, pasi përplasat në tabelë, përfundon në kosh. Të gjithë shkojnë ta përqafojnë "jashtëkësorin" e Cavsit, ndërsa publiku vendës



shpërthen në ovacione pas një tjetër perle të idhullit James. Kualifikimi në finale të Lindjes duket formalitet, sepse në historinë e NBA-s asnjë skuadër nuk ka arritur ta përmbysje disavantazhin 3-0 të serisë në gjysmëfinale. Po kaq emocionuese edhe sfida e "Wells Fargo Center" të Philadelphia 76ers mes 76ers dhe Celtics, që u mbyll me fitoren 98-101 të Bostonit pas kohës shtesë. Një ndeshje krejtësisht e ekuilibruar, me të dyja skuadrat që shkëmbyen kryesimin të paktën 10 herë gjatë ndeshjes. Koha e rregullt përfundoi 89-89, ndërsa në shtesë basketbollistët e rinj të

76ers nuk e patën pjekurinë e duhur, duke humbur disa topa të thjeshtë, që ua dhanë mundësinë lojtarëve të Bostonit të fitonin në fund me tri pikë diferencë. E kotë në fund edhe përpjekja e Belinellit, që nga mesfusha, për ta barazuar rezultatin, me Celticsin që mund t'i mbyllë llogaritë në takimin e radhës, që do të zhvillohet sërish në parketin e Philadelphia. Tatum dhe Rozieri ishin më të mirët për Celticsin, respektivisht me 24 dhe 19 pikë, ndërsa për 76ers nuk mjaftoi Embiid që, përveçse shënoi 22 pikë, kontrolloi plot 19 topa poshtë koshit.

SHKURT

Muriqi me Rizesporin inkuadrohet në Superligën e Turqisë

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, e ka festuar triumfin e skuadrës së vet, Rizespor, në Ligën e Parë të Turqisë. Ekipi nga verilindja e Turqisë e kishte siguruar vendin e parë që javën e shkuar, megjithatë festa e ligjshme u organizua pas ndeshjes së fundit, që të ashtuquajturit "Skifterët e Detit të Zi" zhvilluan në "Yeni Rize Stadi" kundër Gazishehir Gaziantep, duke fituar me shifrat 4-2. Muriqi ka qenë një nga lojtarët kryesorë për skuadrën e drejtuar nga Ibrahim Yzymler. 24-vjeçari iu bashkua Rizesporit në muajin janar nga Gençlerbirliği. Sulmuesi ishte pikë referimi në majën e repartit të avancuar dhe u aktivizua si titullar thujse në të gjitha sfidat duke shënuar tetë gola. Ish-lojtari i Teutës dhe Besës së Kavajës rikthehet menjëherë të luajë në Superligën turke, kësaj radhe me ngjyrat e Rizesporit, klub me të cilin nënshkroi për dy vjet e gjysmë në muajin janar. Në katër vjet në Turqi shtatlarti ka gjetur rrugën e rjetës në 41 raste mes Superligës, Ligës së Parë dhe Kupës së vendit euroaziatik.

Berisha paralajmëron largimin nga Australia


Sulmuesi shqiptar nga Kosova, Besart Berisha, ka paralajmëruar largimin nga Australia, pak pasi u bë kampion me Melbourne Victoryn. Pasi fitoi titullin e katërt të kampionit, 32-vjeçari u pyet nga gazetarët nëse do të qëndrojë te Melbourne edhe për një vit. Ai u ktheu një përgjigje interesante. "Po ju pyes unë tash juve një pyetje. Çfarë tjetër ka mbetur për mua që të fitoj në Ligën A?", kishte thënë ai. Berisha, që ka edhe një vit në kontratë, me këtë deklaratë ka nxitur mediet australiane të shkruajnë për një largim të mundshëm të tij. Për të besohet se ka oferta të majme nga Lindja e Mesme dhe Kina. Ai është në Australi që nga viti 2011.


Neymari ka kërkuar të luajë me Ronaldon

Edhe pse kishin disa kohë që në aksin Madrid-Paris zhurmat ishin zeruar, këtë herë ka menduar e përditshmja madriline "Marca" që të rihapë "debatin" Neymar-Real. Sipas burimeve të kësaj gazete, Neymari ka vendosur ta marrë vetë në dorë situatën e së ardhmes së tij dhe braziliani duket se u ka dërguar një mesazh të qartë drejtuesve, njëkohësisht edhe presidentit Florentino Perez, se ai kërkon të luajë përkrah Cristiano Ronaldos në "Santiago Bernabeu", nga sezoni i ardhshëm. Ish-ylli i Barcelonës, pasi luajti për katër vjet përkrah Lionel Messit, tashmë kërkon të provojë të luajë edhe ndaj fenomenit tjetër të futbollit modern Cristiano Ronaldos, me të cilin ka një marrëdhënie të shkëlqyer, pasi shpesh i kanë shprehur komplimentet njëri-tjetrit, por edhe kur u është dhënë mundësia të luajnë së bashku, qoftë edhe si kundërshtarë, ata janë parë shumë miqësorë. Dhe, ndoshta, sezonin e ardhshëm mund të jenë shokë ekipi te Reali.

Salahi vazhdon ta mahnitë botën

Ai është kthyer në një prej kandidatëve potencialë për ta fituar "Topin e Artë" këtë sezon, por kjo gjë nuk e ka ndaluar aspak Mohamed Salah të vazhdojë me veprimet e tij humanitare. Sulmuesi i Liverpoolit është kthyer në një njeri jashtëzakonisht të dashur në Egjipt. Së fundi, ai ka pagur 450 mijë dollarë për të ndëruar një fabrikë për pastrimin e ujit në fshatin e tij të lindjes Nagrig, e cila do të përdoret për furnizimin e përhershëm të fshatit dhe të gjithë rajonit me ujë të pijshëm. Dashuria e egjiptianëve ndaj Salahit është treguar edhe në zgjedhjet e fundit, teksa edhe pse nuk ishte fare në listë, ai arriti të merrte gati një milion vota.

	Autor: GAZMEND MORINA					LIRIDASHËS	E BËRË PALË-PALË	MURET E NDËRTUARA ME DËRRASA	FUTBOLLISTI ANGLEZ LENON	ISH FUTBOLLISTI GJERMAN UVE	DY BASHKË-TINGËLLORE	I AFROVE (bised.)	EPOKA E RE	KUNDREJT MBI	IPSVICH	MËNJOLLË, NJOMËZ	
	GJENDJE E NJË GJUMI TË THELLË E TË GJATË (biol.)												NIKEL, FLUOR ISH FUTBOLLISTI FAVZI				
	I PARASHIKUAR														ZANORE E PANDERSHME		
	VISHET ME BAR, MBULOHEK ME BAR										ELEMENT KIMIK HEROINA SHQIPTARE IBE						
	HOV, VRULL									PROTOCOL INDEPENDENT MULTICAST ENE QE SHERBEN PER TE MBUSHUR UJE				MARC ANTHONY DOLLAPI I VOGËL PËR ZOGJ			
	SKLLAV								I SULMON KRYEVEPRA E LEONARDO DA VINÇIT								
	KUVEND													DUKAT ZANORE		SHTET NË AZI	
KUJDESTARI (Jur.)													KOHË BRENDË SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË IBERIA				
EPOKA E RE	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO DUNST	FILM I REGJISORIT JAMES CAMERON	SHTET I VOGËL NË AMERIKË	IDHULL	KLUB I YNI FUTBOLLI	MOR, HEJ (pash.) ALBERTO TOMBA			MODELJA AMERIKANE ... TAYLOR KËNGËTAR I YNI				LETRARI ... ALIU KUNDER				
DAMAR I GJAKUT								HARKU, KTHESA FLOTA DETARE					KIK-BOKSIERI MAKSUTAJ E HUTUAR, E SHTANGUR				
I UJIT								PYLL BASHKËT.			KAFSHË GJITARE SHTËPIAKE EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN				ZANORE PRINC ARAB		
SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE TË NGJESHUR						RRJET I NGATËRRUAR KALIMESH E SHTIGJESH PAVLEFSHM-ËRI (Jur.)								EMMY ROSSUM			
DIKTATOR SOVJETIK								PESHQIRI FILMI I PARË SHQIP				DY ZANORE ISLANDA			NOTË MUZIKORE SËPATË E VOGËL		
TECHNOLOGY AND MEDIA				TOP JASHTË LOJE (shq.) QË KA TË BËJË ME FSHATIN, FSHITARAKE					KËNGËTARI POSHKA ANTALYA					KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM FIJE E HOLLË PAMBUKU			
ARKË SHTETËRORE (Lat.)					LUMË NË SHQIPËRI JEVG				URUGUAI SËMUNDJE E TOKËS		KAMPIONI, ASI ENDE						
BASHKËT.	FURRË KU PIQEN TJEGULLA (sh.shq.)	NEVOJË FIZIOLOGJIKE LLOJ VETURE FRANCEZE						I TAKON DY BASHKË-TINGËLLORE							NANTES BANORE E KRYEQYTETIT TË ARABISË SAUDITE		
LLOJ BIME QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE PJESËTARI I POPULLSISË SË GREQISË SË LASHTË							BURRI I MOSHUAR KUZHINË PRANË XHAMISË							AKTORI ... ISLAMI LLOJ HELMI LUFTE			
BANJË ALLATURKA (sh.pashq.)								SHKOVE, ECE (bised.) APO		OREGON REVISED STATUTES PËREMËR PRONOR				DY ZANORE "VIENA"			
SHKRIMTARI ... ZOLA					AKTORI ... HANKS MUAJ I VITIT (shq.)				REGJISORI I NJOHUR ... BURTON MINDERI I ULËT (krah.)				KALLI MISRI I ZGJEDHUR PËR FARË EMËR YNI DJALI				
VARIOLË			EDDIE MURPHY I KAPËRDIJ			KLUBI FUTBOLLI ARGJENTINAS ... LORENZO "TETOVA"				KRYEQYTET I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN METËR, INDIUM					ISH FUTBOLLISTI ÇEK ... KOLLER		
KËNGËTARJA ... KOÇI				ZBRITJA E AEROPLANIT NË TOKË ILION LIKA							"RISANI" DRITËRO AGOLLI			ADEM JASHARI IDRIZ BALAJ			
KRAHINË							ISH KËNGËTARJA ANGLEZE WINEHOUSE (shqjp.) ZANORE			ISH "MISS ALBANIA" ... KOLA TROYES							
SHTET NË EVROPË (pashq.)						PJESËTAR I NJË FISI ILIR								AKTORI I NJOHUR ... STILLER			



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L – 087 për Ndërmarrjet Publike, Komisioni Komunal i Aksionarëve të KRM „PASTËRTIA,, – SH.A - në Ferizaj - publikon:

KONKURS

Për plotësimin e (1 një) anëtarit të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike KRM „PASTËRTIA,, – SH.A -, në Ferizaj.

Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të zgjedhur është 3 (tre) vite.

Procedura e konkursit është e hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

KUALIFIKIMI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, pika 17.3 të Ligjit Nr. 03/L – 087 për Ndërmarrjet Publike, kandidatit për t'u zgjedhur Drejtor në Bordin e Drejtorëve, duhet të plotësojë këto kushte:

- Të kenë përgatitje universitare, përvoja e punës në nivel menaxhimi e nevojshme;
- Të posedoj aftësi dhe shkathtësi profesionale për të punuar në mënyrë të suksesshme në një shoqëri multi etnike;
- Të kenë aftësi për të kryer detyrat e punës në situatë të qetë dhe nën presion.

Kompensimi i drejtorëve të ndërmarrjes KRM „PASTËRTIA,, – SH.A - Ferizaj

Kompensimi i Bordit të Drejtorëve të KRM „PASTËRTIA,, – SH.A do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20 paragrafi 20.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

KUSHTET

Kandidati i cili do të përzgjidhet në Bordin e Drejtorëve të KRM „PASTËRTIA,, – SH.A, duhet:

- Të mos jetë i dënuar dhe nën hetime;
- Të mos kenë bërë shkelje të kodit etik për standardet e sjelljes profesionale;

Kandidati nuk mund të zgjidhet Drejtor në Bordin e Drejtorëve të KRM „PASTËRTIA,, – SH.A nëse:

- Nëse aktualisht është zyrtar, menaxher i ndërmarrjes përkatëse, ose cilëndo nga filialet e saj (Neni 21 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike);
- Nëse ka shërbyer si menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose filialet e saj brenda 5 viteve të kaluara;
- Nëse aktualisht ka qenë ose gjatë tre viteve të kaluara ka pasur çfarëdo marrëdhënie afariste me ndërmarrjen publike përkatëse ose cilëndo nga filialet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë;
- Nëse është Aksionar, Drejtor ose Zyrtar i një shoqërie tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale, afariste me ndërmarrjen publike përkatëse;
- Nëse pranon ose ka pranuar brenda tre viteve të kaluara kompensimin shtesë nga ndërmarrja publike përkatëse ose cilëdo filial e saj (përveç honorarit të drejtorit ose kompensimin stimuluës të përcaktuar me nenin 20. 1 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike;
- ose është anëtarë në skemën pensionale të ndërmarrjes publike përkatëse ose të cilëndo nga filialet e saj.
- Nëse përfaqëson një aksionar i cili posedon me mbi 10 % të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Nëse ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se 9 vite, nga dita e zgjedhjes së tij;
- Nëse është i afërm i shkallës së tretë (neni 2 i Ligjit mbi Ndërmarrjen Publike);
- Nëse është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me ndërmarrjen apo është menaxher i lartë zyrtar, drejtor ose aksionar i cili posedon me më shumë se 2 % të të drejtave të votimit, përkatësisht nëse ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurojnë në ndërmarrjen publike;
- Nëse gjatë periudhës 36 mujore, para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur, i emëruar politik ose bartës i postit udhëheqës apo vendim marrës në një parti politike,
- Nëse ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra do të ndikonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë efektive, me besnikëri në mënyrë të pavarur dhe objektive të i përbush detyrat e tij përgjegjëse ndaj aksionarëve dhe ndërmarrjes publike.

KUSHTET PËR APLIKIM


- Kandidatët për anëtarë të Bordit të Drejtorëve të KRM „PASTËRTIA,, – SH.A -, në Ferizaj duhet t'i dorëzojë këto dokumente:
- Dëshmi për kualifikimin profesional;
- CV – në, letër motivimi;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën që nuk është nën hetime;
- Deklaratën nën betim (formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Aplikuesi duhet të përgatisë deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai / ajo i përbush kushtet e kualifikimit, pavarësinë dhe përgatitjen profesionale, çdo përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm apo neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër përmendur, do të rezultojë me diskualifikimin e menjëhershëm;
- Dokumentacioni duhet të jetë në zarf i mbyllur dhe të dorëzohet në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve, sporteli nr. 1, Komuna e Ferizajt.

Informatat shtesë mund të sigurohen përmes numrit të telefonit: 038/200-46013

Afati i konkursit është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në web faqen zyrtare të komunës, në tabelën e shpalljeve si dhe në televizionet lokale përkatësisht **07.05.2018 -21.05.2018.**

Komisioni i Aksionarëve të KRM „PASTËRTIA,, – SH.A në Ferizaj datë: **04.05.2018**

Kryesuesi i komisionit
B. Sahaj



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

Na osnovu odredaba člana 16. Zakona br. 03 / L-087 o Javnim preduzećima, Komisija opštinskih akcionara RKO, "PASTËRTIA" - A.D. - Uroševac - objavljuje:

KONKURS

Dopuniti jednog (1) člana Odbora direktora Javnog preduzeća RPO "PASTËRTIA" - A.D, u Uroševcu.

Mandat izabranih članova Odbora direktora je 3 (tri) godine.

Postupak konkurisanja je otvoren za sve zainteresovane kandidate

KVALIFIKACIJA I STRUČNA SPREMA

Na osnovu člana 17, tačka 17.3 Zakona Br. 03/L – 087 za Javna preduzeća, kandidat da bi bio izabran za Direktora u Odboru direktora, treba da ispunjava sledeće uslove:

- Treba imati univerzitetisku spremu, radno iskustvo na nivou potrebnog menadžmenta;
- Da poseduje sposobnost i profesionalne veštine za uspešan rad u multietničkom društvu;
- Treba da ima sposobnost obavljanja radnih zadataka u mirnoj situaciji i pod pritiskom.

Naknada direktora preduzeća RKO "PASTËRTIA" - A.D – Uroševac

Naknada Odbora direktora RKO "PASTËRTIA" - A.D izvršice se u skladu sa odredbama člana 20 stav 20.2 Zakona o javnim preduzećima.

USLOVI

- Kandidat koji će biti izabran u Upravnom odboru RKO "PASTËRTIA" - A.D, mora:
- Da nije bio osuđen i da nije pod istragom;
- Da nije prekršio etički kodeks za standarde profesionalnog ponašanja;
- Kandidat ne može biti izabran za direktora Upravnog odbora RKO "PASTËRTIA" - A.D, ako:
- Da nije trenutno službenik, rukovodilac odgovarajućeg preduzeća ili bilo koje od njenih filijala (član 21 Zakona o javnim preduzećima);
- Da nije u poslednjih 5 godina radio kao rukovodilac relevantnog javnog preduzeća ili njegovih podružnica;
- Da trenutno jeste ili je u toku protekle tri godine imao poslovne odnose sa ovim javnim preduzećem ili bilo koje od njenih podružnica, bilo direktno ili indirektno;
- Da nije akcionar, direktor ili službenik kompanije ili drugo pravno lice koje ima materijalne poslovne odnose sa relevantnim javnim preduzećem;
- Da ne prima ili je primio u poslednje tri godine dodatnu naknadu od relevantnog javnog preduzeća ili bilo koje od njenih podružnica (osim naknade direktora ili naknade podsticaja navedenim u članu 20. 1. Zakona o javnim preduzećima);
- Ili je član penzijske šeme odgovarajućeg javnog preduzeća ili bilo koje od njenih podružnica.
- Da ne predstavlja akcionara koji poseduje više od 10% akcija s pravom glasa u relevantnom Javnom preduzeću;
- Da nije je služio u Odboru direktora odgovarajućeg javnog preduzeća više od devet godina od dana njegovog izbora;
- Da nije srodnik trećeg stepena (član 2 Zakona o javnim preduzećima);
- Da nije službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u nekon trgovinskom udruženju koje konkuriše sa kompanijom ili je viši menadžer, direktor ili akcionar koji poseduje više od 2% glasačkih prava, ili ako ima značajan finansijski interes u bilo kojem trgovinskom udruženju koje konkuriše u javnom preduzeću;
- Da nije u roku od 36 meseci pre dana podnošenja zahteva bio je izabrani zvaničnik, politički imenovani ili nosilac rukovodećeg položaja ili odlučivanja u nekoj političkoj stranci,
- Da ne postoji sukob interesa koji bi po prirodi prouzrokovao da takvo lice ne bude u stanju da efektívno, verno, nezavisno i objektivno ispunji svoje odgovorne dužnosti prema akcionarima i javnom preduzeću.

USLOVI ZA PRIJAVLJIVANJE

- Kandidati za članove Odbora direktora RKO, PASTËRTIA ,, - A.D, u Uroševcu trebaju dostaviti sledeće dokumente:
- Dokaz o profesionalnoj kvalifikaciji;
- CV, motivaciono pismo;
- Dokaz radnog iskustva;
- Izvod rođenja;
- Certifikat da nije pod istragom;- Izjava pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije);
- Podnosilac prijave mora pripremiti izjavu pod zakletvom u kojoj se izjašnjava da on ili ona ispunjava uslove za kvalifikaciju, nezavisnost i profesionalne kvalifikacije, bilo kakvo materijalno obmanjivanje, bilo namerno ili nemarno, ili materijalnu promenu od informacija navedenih u gornjoj izjavi , rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom;
- Dokumentacija mora biti u zapečaćenom kovertu i dostavljena Centru za službu građana, Šalter br. 1, opština Uroševac.

Dodatne informacije možete dobiti putem telefonskog broja: 038 / 200-46013

Krajnji rok konkursa je 15 dana od dana objavljivanja na zvaničnom sajtu opštine, oglasnoj tabli i lokalnim televizijama **07.05.2018 -21.05.2018.**

Komisija akcionara RKO „PASTËRTIA,, – A.D u Uroševcu dana: **04.05.2018**

Predsedavajući Komisije
B. Sahaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

ZYRA E KRYEMINISTRIT SHPALL TË LIRË KËTË VEND TË PUNËS:

I. ZYRA PËR PUBLIKIMIN E GAZETËS ZYRTARE

Një(1) Zyrtar i lartë për përkthim (shqip-turqisht)

Numri i referencës: ZKM-GZK-006

Koeficienti: 8

Detvat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të zyrës për publikimin e gazetës zyrtare kryen detvat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Bëjnë përkthimin e të gjitha akteve juridike, dokumenteve dhe shkresave të ndryshme që publikohen nga Zyra për Publikim, nga gjuha shqipe në gjuhën turke dhe anasjelltas;
2. Bëjnë lekturimin e të gjitha akteve juridike, dokumenteve dhe shkresave të ndryshme që dalin nga Zyra për Publikim, nga gjuha shqipe në gjuhën turke dhe anasjelltas;
3. Në rast nevojje përkthen si similtane për nevojë të zyrës për publikim dhe ZKM-së dhe interpretojnë tekstet e shkruara nga gjuha shqipe në atë turke dhe anasjelltas;
4. Bëjnë përkthimin e dokumenteve dhe shkresave të ndryshme që janë në kompetencë të Zyrës për Publikim, sidomos të teksteve juridike, korrespondencën e shkruar nga gjuha shqipe në atë turke dhe anasjelltas;
5. Sipas kërkesës të Drejtorit përgatitë planin e vet vjetor të punës;
6. Përgatitë raporte javore, mujore dhe vjetore për punën e vet të kryer;
7. Kryen edhe punë tjera për ZPGZ që i caktohen nga Drejtori i Zyrës.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Fakulteti i gjuhës dhe letrarisë shqipe, turke;
- Tri (3) vite përvojë pune profesionale në lekturim, përkthim.
- Kërkohej njohja e gjuhës turke (në të folur dhe shkruar);
- Njohës i mirë i gjuhës shqipe dhe /ose serbe. Njohja e gjuhëve të tjera si anglishtja etj është përparësi.
- Të jetë në gjendje të perkthej simulant nga gjuha shqipe-turke dhe anasjelltas.
- Shkathësitë kompjuterike, përfshirë njohuritë Windows, Outlook, Microsoft Works/Office, Excel, Internet dhe të krijimit të prezantimeve.
- Aftësi në të shkruar.
- Të jetë energjik, të ketë shkathësi të mira ndër njerëzore dhe të jetë i/e gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës dhe trysni kohe.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Zyra e Kryeministrit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASIIT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (ruga Nëna Tereze p.n.). Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen : <http://www.kryeministri-ks.net/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në Divizionin e burimeve njerëzore, Ndërtesa e Qeverisë, kati i IV, zyra nr. 406.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Kohëzgjatja e cmërimit sipas LSIIC, duke përfshirë periudhën e punës provuese një (1) vjeçare.

Afati i konkurimit është prej datës: 07/05/2018 deri me datë 21/05/2018, deri në orën 16:00.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 14 818 dhe 038 200 14 817.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Kancelarija Premijera-Office of the Prime Minister

KANCELARIJA PREMIJERA objavljuje slobodnim sledeće radno mesto:

KANCELARIJA ZA OBJAVLJIVANJE SLUŽBENOG LISTA

Jedan (1) Visoki službenik za prevodenje (albanski -turški)

Referentni broj: KP- SLK-006

Koeficijent : 8

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom direktora Kancelarije za objavljivanje Službenog lista obavlja sledeće dužnosti i odgovornosti:

1. Obavlja prevodenje svih pravnih akata, raznih dokumenata i dopisa koji se objavljuju od strane Kancelarije za objavljivanje sa albanskog na turški jezik i obrnuto;
2. Obavlja lekturu svih pravnih akata, raznih dokumenata i dopisa koje proističu iz Kancelarije za objavljivanje sa albanskog na turški jezik i obrnuto;
3. Ako je potrebno, vrši simultane prevode za potrebe kancelarije za objavljivanje i KP i tumači pisane tekstove sa albanskog na turški jezik i obrnuto;
4. Vršiti prevod dokumenata i raznih dopisa koji su u nadležnosti Kancelarije za objavljivanje, posebno pravne tekstove, pisanu korespondenciju od albanskog na turški i obrnuto;
5. Na zahtev direktora priprema svoj godišnji plan rada;
6. Priprema nedeljne, mesečne i godišnje izveštaje o svom radu ;
7. Obavlja i druge poslove po nalogu direktora KOSL.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Fakultet za albanski, turški jezik i književnost;
- Tri (3) godine stručnog radnog iskustva u oblasti lekture i prevodenja
- Potrebno znanje turskog jezika (govornog i pisanog);
- Dobro poznavanje albanskog i / ili srpskog jezika. Znanje drugih jezika kao što su engleski, itd je prednost.
- Treba da je u stanju da simultano prevodi sa albanskog na turški i obrnuto.
- Poznavanje rada na kompjuteru, uključujući poznavanje Windows, Outlook, Microsoft Works / Office, Excel, Internet i stvaranje prezentacija
- Veštine pisanja.
- Treba biti energičan, da ima sposobnost izgradnje dobrih međuljudskih odnosa i da bude / spreman da radi sa fleksibilnim sati rada i pod pritiskom vremena.

OSNOVNI PODACI ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA KONKURISA

Kancelarija Premijera pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja aplikacije od strane svih zajednica na Kosovu.

Ne-većinske zajednice imaju pravo na fer i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe kao što je navedeno u članu 11. stav 3 Zakon br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo.

Uz aplikaciju se treba priložiti sledeća prapratna dokumentacija: popunjeni obrazac za aplikaciju, dokaz o obrazovnim i stručnim kvalifikacijama (diplome stečene u inostranstvu moraju biti verifikovane od strane MONT-a), dokaz radnog iskustva, dve reference .

Zahtev za zapošljavanje i opis radnog mesta se može dobiti na recepciji zgrade Vlade Republike Kosovo (ul. Majke Tereze bb). Zvanični obrazac za aplikaciju, možete naći i na web stranici: <http://www.rks-gov.net/pm/>; <http://www.kryeministri-ks.net/zck/>.

Dokumentacija mora biti dostavljena Kancelariji za ljudske resurse, zgrada Vlade, IV sprat, kancelarija br. 406. Korišćenje pogrešnog obrazca i nepotpunog sa podacima koji su potrebni, će se smatrati nevažećim.

Zbog velikog broja primljenih zahteva, samo kandidati koji su ušli u uži izbor će biti kontaktirani. Kandidati koji su izabrani u uži izbor će proći kroz pismeni ispit i intervju.

Trajanje imenovanja prema ZSL, uključujući i period probnog rada je godinu dana.

Rok za konkurisanje je od dana 07/05/2018 do dana 21/05/2018, do 16:00.

Prijave pristigle nakon poslednjeg roka konkursa neće biti prihvaćene.

Za dodatne informacije, pozovite brojevi: 038 200 14 818 i 038 200 14 817

Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sout

Kryetari i Komunës
Nr. 01-111/01-0030623-2/18 dt. 04.05.2018
Mitrovicë

Në bazë të nenit 11 dhe të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Mitrovicës së Jugut shpallë:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Institucioni : Komuna e Mitrovicës së Jugut
Drejtoria: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2 - BF/210
Kategoria funksionale/Grada: Grada 9 (Koefficienti 7)
Numri i referencës: JP00033081

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe zyrtarin e lartë harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre;
- Mbështetja në hartimin e planeve buxhetore vjetore të DKRS-së, koordinimi i punëve me zyrtarët përkatës brenda drejtorisë për të siguruar që planet kompletohen me përpikëri dhe sipas afatëve;
- Kujdeset, analizon dhe vlerëson propozimet buxhetore dhe bënë ekzaminimin e tyre duke shqyrtuar korrektësinë, saktësinë dhe tërësinë si dhe kontributon në përgatitjen e buxhetit përfundimtar për dërs;
- Ofron këshilla dhe udhëzime, përfshirë trajnime për stafin lidhur me përgatitjen dhe shpenzimin e buxhetit si dhe politikën dhe procedurat financiare;
- Monitoron shpenzimet e buxhetit të dërs-së gjatë gjithë vitit dhe rekomandon rialokimin e buxhetit kur është e nevojshme si dhe përgatitë raporte mbi shpenzimet buxhetore;;
- Siguron disponueshmërinë dhe alokimin e buxhetit në përputhje me procesin e fillimit të çdo aktivitetit në dërs dhe buxhetin e planifikuar;
- Zhvillon dhe zbaton politikën, procedurat dhe praktikën financiare dhe operative të cilat lehtësojnë dhe mbështesin menaxhimin financiar
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Procedurat e konkurrimit: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare në drejtimin Ekonomik.

- **Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:** Minimumi 2 (dy) vite përvojë pune; Njohuri dhe përvojë në fushën e buxhetit dhe financave; Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit; Shkathtësi humbues, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave; Aftësi për përmbyshje të detyrave dhe punëve nën presion; Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, internet)
- **Kohëzgjatja e emërimit:** Nepunësi në karrierë.
- **Data e mbylljes së konkursit:** Konkursi është i hapur nga data 07.05.2018 deri më 21.05.2018.
- **Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 10 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës dhe të bashkëngjiten këto dokumente: diploma mbi kualifikimin, fotokopja e letërnojotimit; ekstrakti i lindjes; dëshmi mbi përvojën e punës; dhe certifikata që dëshmojnë njohuri nga fusha përkatëse. Dokumentet duhet të jenë në njërin prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund të bëni në 028 532 104.
- **"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.**
- **Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë të përfqejshim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, sipë specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".**
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kete Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Predsednik Opštine
Br. 01-111/01-0030623-2/18 dt. 04.05.2018
Mitrovica

Shodho članovima 11 i 18 Zakona br. 03 / L-149 o Cvilnoj službi Republike Kosovo, Pravilnik br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja u Cvilnoj službi Kosova i članu 4.2 Statuta opštine, opština Južna Mitrovica objavljuje:

OGLAS ZAPOŠLJAVANJA

Institucija : Opština Južne Mitrovice
Uprava: Kulturou omladinu i sport
Naziv radnog mesta: Zvaničnik za budžet i finansije 2 – BF/210
Funkcionalna kategorija/Grada: G - 9 (koefficient 7)
Referentni broj: JP00033081

Zadaci i odgovornosti:

- U saradnji sa supervzorom i višim službenikom, izrađuje planove rada za sprovođenje zadataka postavljenih na osnovu ciljeva i daje preporuke u vezi sa sprovođenjem ovih zadataka;
- Podržava izradu godišnjih budžetskih planova UKOS-a, koordinira rad sa relevantnim službenicima u okviru Direkcije kako bi se osiguralo da se planovi izvrše korektno i blagovremeno;
- Stara se, analizira i procenjuje predloge budžeta i vrši njihovo razmatranje ispitivanjem korektnosti, tačnosti i potpunosti, kao i doprinosi pripremi finalnog budžeta za UKOS;
- Pruža savete i smernice, uključujući obuku osoblja o pripremi i trošenju budžeta, kao io finansijskim politikama i procedurama;
- Nadgleda budžetske troškove tokom cele godine i preporučuje preusmeravanje budžeta kada je to potrebno i priprema izveštaje o budžetskim troškovima;
- Obezbeduje raspoloživost i raspodelu budžeta u skladu sa procesom početka svake aktivnosti U UKOS i planiranim budžetom;
- Razvija i primenjuje politike, procedure, finansijske i operative postupke koji olakšavaju i podržavaju finansijsko upravljanje;
- Obavlja i druge dužnosti u skladu sa zakonima i propisima koje mu se dodelce od strane supervzora i koje mu se mogu povremeno tražiti na razuman način.

Procedure konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve gradane Republike Kosova koji su punoletni, imaju potpunu sposobnost delovanja, imaju potrebnu školsku spremu i fizičke veštine potrebne za odgovarajuću poziciju.

Potrebno obrazovanje: Univerzitetska diploma iz Ekonomije.

- **Sposobnosti / iskustvo i ostali atributi koji se zahtevaju:** Minimum 2 (dve) godine radnog iskustva; Znanje i iskustvo iz oblasti budžeta i finansija; Veštine u komuniciranju, planiranju i vodstvu tima; Veštine istraživanja, analitičke veštine i veštine evaluacije, kao i formulisanje preporuka i saveta; Sposobnost ispunjavanja dužnosti i radnih zadataka pod pritiskom; Sposobnost kompjuterskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, internet).
- **Trajanje imenovanja: službenik za karijeru.**
- **Datum zatvaranja konkursa:** Konkurs je otvoren od dana 07.05.2018 do 21.05.2018.
- **Podnošenje zahteva:** Aplikacije se primaju i dostavljaju u kancelariji br. 10 u opštini Južna Mitrovica. U prijavi, treba jasno navesti naziv pozicije i referentni broj i dodatni ova dokumenta: diploma o kvalifikaciji, fotokopija lične karte, izvod rođenja, dokaz o radnom iskustvu i certifikati koji dokazuju znanje iz tražene oblasti. Dokumenti moraju biti na jednom od službenih jezika u opštini. Telefonski kontakti se mogu izvršiti na 028 - 532 104.

"Kosovska civilna služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve gradane Kosova i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu. Neveštinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima državne uprave, centralnoj i lokalnoj upravi, kako je navedeno u članu 11 stav 3 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo".

Prijave poslate nakon poslednjeg datuma i nepotpuni prijave neće biti prihvaćene. Zbog velikog broja primljenih prijava kontaktiraće se samo kandidati koji su odabrani na izbornoj listi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lavdim Bytyqi nga Kishnica shpallë të pavlefshme dëftesat e klasës së dhjetë, njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë të shkollës së mesme "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

▶ Hilmi Ballazhi shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

▶ Atila Vila shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme Sh.M.L "Dardania" Hani Elezit.

▶ Semine Curri shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme SH.M.L "Dardania" Hani Elezit.

▶ Ar gjend Llukavi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Alil Memaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHF "Naim Frasheri" Vlashnje.

▶ Senad Arifi shpall te pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushë Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

▶ Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejhe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe deponitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

▶ Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshepejte



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333